

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6061
E hënë, 13 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi sot do të
intervistohet nga
Gjykata Speciale | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURTEZAJ | FAQE 4-5

DIALOGU KOSOVË-SERBI DUHET TË PËRMBYLLET KËTË VIT



Valon Murtezaj, këshilltar për politikë të jashtme i kryeministrit Avdullah Hoti, ka bërë me dije se procesi i dialogut Kosovë - Serbi nuk duhet të zgjasë pafund. Në këtë intervistë dhënë

për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky proces duhet të përmbyllet brenda këtij viti. Murtezaj ka vlerësuar se bashkëpunimi amerikan dhe evropian në këtë proces është jetik për

Republikën Kosovën. Ai ka deklaruar se Kosova i ka të qarta parimet dhe objektivat që synon t'i arrijë në këtë proces, duke shtuar se Kosova nga ky dialog pret njohjen e shtetësisë së saj

KOSOVA DHE SERBIA KANË RIFILLUAR BISEDIMET ME NDËRMJETËSIMIN E BASHKIMIT EVROPIAN (BE)

HOTI DHE VUÇIQI DO TE TAKOHEN MË 16 KORRIK

Kosova dhe Serbia janë pajtuar që më 16 korrik të ndodhë takimi ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë,

Aleksandër Vuçiq, në Bruksel. Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për këtë proces, Miroslav Lajčak, ka thënë se pajtimi ka ndodhur në



takimin mes palëve që është mbajtur të dielën në formë virtuale. Ai i ka falënderuar palët për angazhimin konstruktiv



301 PACIENTË ME COVID-19 TË SHTRIRË NË QKUK DHE SPITALET E PËRGJITHSHME



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

PA UÇK-në DHE LUFTËN E SAJ ÇLIRIMTARE KOSOVA KTHEHET NË NJË PARCELË TË GJITHKUJT (5) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTAKUZA, DËSHMIA NË HAGË DHE TRI QËNDRIME NDAJ ÇËSHTJES THAÇI F. 11

Bedri
ISLAMI



AKTUALE

ZGJATET PËR NJË VIT MISIONI I EULEX-IT NË KOSOVË F. 6

SITUATA ME PANDEMINË, A DUHET TË SHPALLET GJENDJA E JASHTËZAKONSHME? F. 3

EKONOMI

GËRXXHALIU: KEMI VARROSJE TË EKONOMISË F. 8

AZEMI: GJENDJA E PUNËTORËVE PRIVAT ËSHTË RËNDUAR F. 8

KULTURË

DRAMA E PËRDITSHME E SHOQIPTARIT NË "ËNDRRA, SHI DHE LULE" F. 13

Thaçi sot do të intervistohet nga Gjykata Speciale

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të dielën ka udhëtuar për Hagë, ku sot (e hënë) do të merret në pyetje nga Prokuroria e Gjykatës Speciale. Udhëtimi i Thaçit drejt Hagës vjen pas propozimaktakuzës kundër tij dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli, e cila është bërë publike më 24 qershor.

Pas propozimaktakuzës, Thaçi ka vizituar disa nga familjet e dëshmorëve, për ta dhënë mesazhin se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e çlirimtare. Po ashtu, para nisjes për në Hagë, Thaçi të shtunën dhe të dielën ka bërë dy vizita mjaft domethënëse, te varri i komandantit legjendar i UÇK-së, Adem Jashari dhe te varri i simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçi. Nga kompleksi memorial "Adem Jashari", duke iu referuar propozimaktakuzës kundër tij, ka thënë se dielli do të lindë përsëri. "Jam sonde këtu në Prekaz për të bërë nderime për bashkëluftëtarin dhe komandantin Adem Jashari. Për t'u bërë nderime të gjithë luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, heronjve të kombit. Jam këtu në këtë muzg veror edhe për të ritheksuar fuqishëm se dielli do të lindë përsëri", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa pas homazheve te varri i



Adem Demaçit, Thaçi ka thënë simboli i rezistencës kombëtare ka dhënë gjithçka për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, duke shtuar se sakrificat e tij është sinonim i lirisë. "Jam sot këtu për ta nderuar dhe respektuar simbolin e rezistencës kombëtare, emblemën e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, për ta nderuar jetën, përkushtimin dhe sakrificën e Adem Demaçit, i cili dha gjithçka për lirinë, pavarësinë e Kosovës dhe bashkimin kombëtar. Jeta dhe vepra e Demaçit do të jenë gjithmonë simbol, por edhe

motiv dhe energji për të gjithë atë angazhim që na pret edhe në të ardhmen që të jemi pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian dhe për ruajtjen e raporteve të përjetshme me ShBA-në. Sakrificat e Adem Demaçit është sinonimi i lirisë së Kosovës dhe motiv për të gjithë ne që sot jemi të lirë dhe të pavarur", ka thënë Thaçi.

Më 8 korrik, Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar se të hënën do të niset për Hagë. Në këtë kontekst, ai kishte deklaruar se shumë pjesëtarë të UÇK-së janë ballafaquar me

drejtësinë ndërkombëtare të UNMIK-ut, Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavi, EULEX-it dhe drejtësinë vendore. "Kosova, edhe pse viktimë, bashkëpunoi me organet e drejtësisë për trajtimin e pretendimeve për krime lufte. Në dy vjetët e fundit shumë ish-bashkëluftëtarë janë intervistuar nga Dhomat e Specializuara, brenda dhe jashtë vendit. Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, më lejoni të ndaj me ju se të hënën do të udhëtoj për në Hagë si i ftuar nga Prokuroria Speciale për t'u intervistuar.

Derisa bashkëluftëtarët e mi dhe unë do të përballemi me dinjitet dhe integritet me drejtësinë ndërkombëtare, ju ftoj që të bashkuar t'i përballojmë sfidat me të cilat po përballlet vendi. Uniteti qytetar, bashkëjetesa ndëretnike, stabiliteti institucional dhe besimi në institucione janë të domosdoshme që Kosova ta jetësojë vizionin që të jetë pjesë e NATO-s, Bashkimit Evropian dhe ta ruajë miqësinë e përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", kishte shkruar Thaçi.

Në anën tjetër, më 29 qershor, në adresimin e parë para qytetarëve pas propozimaktakuzës, presidenti Thaçi kishte deklaruar se gabime politike në paqe mund të ketë bërë, por krime lufte asnjëherë! "Edhe po të kthehesha mbrapa, në kohën e zezë të Slobodan Millosheviqit, do të bëja të njëjtën gjë, duke iu përgjigjur plumbit armik me plumbin e etjes për liri dhe duke mos i hyrë kurrë në hak asnjë qytetari serb, rom apo shqiptar", kishte thënë Thaçi.

Kujtojmë se propozimaktakuza ndaj Thaçit dhe Veselit ishte publikuar në ditën që presidenti i Kosovës ishte nisur drejt ShBA-së për të marrë pjesë në takimin e Uashingtonit, i cili pritet të mbahej më 27 qershor në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për shkak të propozimaktakuzës ky takim ishte anuluar.

Ali Ahmeti: Maqedonia e Veriut do ta ketë kryeministrin shqiptar, votoni numrin 9

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka ftuar qytetarët e Maqedonisë së Veriut që ta votojnë kandidatin shqiptar për kryeministër, Naser Ziberi dhe këtë parti në zgjedhjet parlamentare. Ai ka thënë se tashmë ka ardhur koha që Maqedonia ta ketë kryeministrin shqiptar. Ahmeti ka theksuar se me kryeministrin shqiptar do të përfitojnë të gjithë

SHKUP, 12 KORRIK (ER) - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se ideja për kryeministër shqiptar të Maqedonisë së Veriut daton qysh nga viti 2009. Ai ka thënë se këtë ide e kanë materializuar në këto zgjedhje të cilat do të mbahen nga nesër (e hënë) e do të vazhdojnë deri të mërkurën. "Fushatën për zgjedhjet e 15 korrikut e nisëm në Prespë, ndërsa e rumbullakuam mbrëmë në Ohër, jo rastësisht. Në Kongresin Zgjedhor të BDI-së vitin

e kaluar i përcaktuam vijat tona të kuqe për të ardhmen e vendit dhe të qytetarëve, e ato janë barazia e plotë, integrimi në NATO dhe në Bashkimin Evropian, ndërsa këto arrihen nëpërmjet Marrëveshjes së Ohrit, Marrëveshjes së Prespës dhe asaj të fqinjësisë së mirë nga të cilat kthim pas nuk ka. Në këto zgjedhje, si pjesë e trashëgimisë sime në politikëbërjen në këtë vend, e aktualizuar idenë e zgjedhjes së kryeministrit të parë shqiptar të vendit tonë të përbashkët, ide kjo që daton që në Kongresin tonë të



Dytë Zgjedhor më 17 dhjetor të vitit 2009 në Shkup. Trashëgimia ime dhe e bashkëpunëtorëve të mi është ndërtimi gur pas guri i kalasë së barazisë së plotë të shqiptarëve dhe të tjerëve në vendin tonë euroatlantik", ka deklaruar Ahmeti. Më tutje, Ahmeti ka thënë se

tashmë ka ardhur koha që Maqedonia e Veriut ta ketë kryeministrin shqiptar. Ai ka shtuar se me kryeministrin shqiptar do të përfitojnë të gjithë, pavarësisht përkatësisë etnike apo politike. Lideri i BDI-së është shprehur i bindur që këtë herë Maqedonia do

ta ketë kryeministrin shqiptar. "Të dashur qytetarë, ky synim nuk është vetëm një ëndërr. Ky synim realizohet sepse ne e kemi matur shtatë herë dhe e kemi prerë një herë, prandaj bashkohuni të gjithë rreth numrit nëntë dhe jepini krahë gjeneratës së re që të rumbullakojë trashëgiminë tonë të barazisë së plotë. Ne po guxojmë, bashkëngjitur dhe së bashku do ta shkruajmë historinë për ta bërë ardhmërinë. Kjo është ajo që sot po ua mundësojmë fëmijëve dhe nipërve e mbesave tona: Besimi se ne mund të arrijmë gjithçka që ëndërrojmë. Besimi se gjithsecili prej jush vlen dhe këtë do ta dëshmojë më 15 korrik duke rrethuar numrin 9", është shprehur Ahmeti.

Kandidat për kryeministër shqiptar në Maqedoninë e Veriut është Naser Ziberi nga radhët e BDI-së.

Situata me pandeminë, a duhet të shpallet gjendja e jashtëzakonshme?

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 KORRIK - Pas rritjes së numrit të personave të infektuar me Covid-19 dhe rritjes së numrit të rasteve që kanë përfunduar me vdekje, Kosova është duke shqyrtuar mundësinë që të shpallë gjendje të jashtëzakonshme. Ky veprim është komentuar në mënyra të ndryshme nga zyrtarë qeveritarë, profesionistë shëndetësorë dhe ekspertë të sigurisë.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në një postim në rrjetin social "Facebook", u është drejtuar qytetarëve të Kosovës që t'i respektojnë masat dhe, siç ka shkruar ai, të mos e imponojnë vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme. "Mos na impononi vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Nuk jemi qeveri represive, por shtet demokratik. Më dhemb shpirti ta shoh Kosovën e mbyllur", ka shkruar Zemaj.

Lul Raka, mikrobiolog, ka thënë se çfarëdo vendimi që merret duhet të analizohet hollësisht nga të gjitha këndvështrimet dhe institucionet relevante duke dhënë të gjithë opusin e mundshëm të impaktit të intervenimeve të ndërmarra. Ai ka thënë se reagimi nuk duhet të jetë reaktiv dhe vendimit politik duhet t'i paraprijë qasja shkencore. "Dy faktorët kryesorë të rritjes së numrave janë: mosrespektimi masiv nga qytetarët dhe mungesa e mbikëqyrjes dhe kontrollit nga shteti. Këtu është problemi kyç dhe këtu duhet të jetë fokusi i përgjigjes pa lënë anash rekomandimet e fundit të ECDC", ka thënë Raka. Sipas tij,

zgjidhja e mundshme mund të jetë të gjithë me maska. "Maskat duhet të jenë obliguese. Të blihen maska shumëpërdorimëshe nga shteti dhe të shpërndahen në popull. Kjo qasje mund ta ulë lakoren. Mund të zbatohet për një kohë më të gjatë, njëkohësisht parandalon edhe sëmundjen edhe ruan ekonominë dhe shëndetin mendor", ka thënë Raka.

Njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka folur lidhur me paralajmërimin për shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë si veprim për ta luftuar Covid-19. Ai ka thënë se në opinionin u shfaqen shumë qëndrime kontradiktore për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë. "Kujtoj që një vendim i tillë në momentin aktual të rrezikut nga Covid-19 është i panevojshëm dhe nuk përbën formën me të cilën do të ndalohej shpërndarja e virusit. Gjendja e jashtëzakonshme shpallet vetëm atëherë kur ka rrezik immanent nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm ku të gjitha format e tjera do të shtereshin dhe rrjedhimisht do të lypsej mobilizimi maksimal fizik i të gjitha resurseve në dispozicion, ku ushtria ka rëndom rol prijës", ka shkruar Qehaja në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka shtuar se rrjedhimisht ka konstatuar dhe vazhdon të konstatojë se argumentet për vendosjen e rendit publik (lexo: disiplinimin e popullatës) nëpërmjet hyrjes në fuqi të gjendjes së jashtëzakonshme nuk qëndrojnë.

"Në vend të saj, Qeveria duhet të mendojë për forma strikte të vendosjes së masave duke ngritur nivelin e inspektimeve dhe sanksionimeve, gjithmonë duke llogaritur në mbështetjen shtesë të strukturave të rendit, krahas formave të tjera vetëdijesuese", ka thënë eksperti i sigurisë, Ramadan Qehaja.



vendosjes së masave duke ngritur nivelin e inspektimeve dhe sanksionimeve, gjithmonë

duke llogaritur në mbështetjen shtesë të strukturave të rendit, krahas formave të tjera

vetëdijesuese", ka thënë eksperti i sigurisë, Ramadan Qehaja.

Çfarë thotë Kushtetuta për gjendjen e jashtëzakonshme?

Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti i vendit vendos për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, në konsultim me kryeministrin, kur ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike, ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.

Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë.

Me shpalljen e gjendjes së

jashtëzakonshme, presidenti i Republikës së Kosovës shpallë menjëherë dekretin, i cili përcakton natyrën e kërcënimit dhe çfarëdo kufizimi për të drejtat dhe liritë. Në këtë rast, Kuvendi i Kosovës brenda 48 orëve mund ta japë pëlqimin me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i presidentit nuk ka forcë as efekt. Në një rast tjetër, nëse ka rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës, ose ekziston një fatkeqësi natyrore në tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij, Kuvendi brenda dyzet e tetë orëve mund

ta japë pëlqimin e tij me shumicën e votave të të gjithë deputetëve dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i presidentit nuk ka forcë as efekt. Gjendja e jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vazhdon të kërcënojë rrezikun dhe nuk mund të zgjatë më shumë se për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh.

Me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, gjendja e jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, mund të zgjatet për periudha pasuese prej tridhjetë ditësh, por jo më shumë se për nëntëdhjetë ditë shtesë gjithsej.

301 pacientë me Covid-19 të shtrirë në QKUK dhe spitalet e përgjithshme

PRISHTINË, 12 KORRIK - 301 pacientë të konfirmuar me Covid-19 po vazhdojnë të marrin tretman shëndetësor në klinikat e QKUK-së dhe Spitalet e Përgjithshme të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Sipas raportit të datës 12 korrik, në klinikat e QKUK-së ka të shtrirë 190 pacientë, kurse në shtatë spitalet e përgjithshme 111 pacientë. Prej tyre, 123 me oksigjenoterapi në QKUK dhe 49 në spitalet e përgjithshme.

Nga numri i përgjithshëm i pacientëve të konfirmuar me Covid-19, 29 janë në gjendje më të rënduar, nën përkujdesje të vazhdueshme intensive. Sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të

Kosovës, numri total i rasteve pozitive është 4 715 raste nga 27 723 persona të dyshimtë me këtë virus, me gjithsej 101 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese.

Sipas IKShPK-së, numri i përgjithshëm i të shëruarve është 2 227 raste. "Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomi, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", është thënë në mesazhin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, VALON MURTEZAJ

DIALOGU KOSOVË - SERBI DUH



Valon Murtezaj, këshilltar për politikë të jashtme i kryeministrit Avdullah Hoti, ka bërë me dije se procesi i dialogut Kosovë - Serbi nuk duhet të zgjasë pafund. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se ky proces duhet të përmbyllet brenda këtij viti. Murtezaj ka vlerësuar se bashkëpunimi amerikan dhe evropian në këtë proces është jetik për Republikën Kosovën. Ai ka deklaruar se Kosova i ka të qarta parimet dhe objektivat që synon t’i arrijë në këtë proces, duke shtuar se Kosova nga ky dialog pret njohjen e shtetësisë së saj

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Këshilltari për politikë të jashtme i kryeministrit Avdullah Hoti, Valon Murtezaj, ka deklaruar se dialogu Kosovë - Serbi duhet të përmbyllet brenda këtij viti. Ai ka treguar se kryeministri Hoti këtë gjë e ka kërkuar në takimet e fundit që ka pasur me presidentin francez në Paris dhe në samitin virtual të Parisit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se Kosova nga ky dialog pret njohjen e shtetësisë së saj. “Procesi nuk duhet të zgjasë pafund, përkundrazi kryeministri Hoti ka kërkuar që dialogu të përmbyllet gjatë vitit 2020. Sidoqoftë, ky proces është

kompleks dhe kemi të bëjmë me sjellje destruktive të Qeverisë së Serbisë. Prandaj edhe ndihmesa e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian është e rëndësishme së pazëvendësueshme” ka thënë Murtezaj. Ai ka vlerësuar se bashkëpunimi amerikan dhe evropian në këtë proces është shumë i rëndësishëm për Kosovën. Sipas Murtezajt, ShBA-ja dhe BE-ja duhet ta plotësojnë njëra-tjetrën në këtë proces. “Për Kosovën bashkëpunimi evropian dhe amerikan është jetik. Në këtë proces, roli gjerman dhe francez nga ana e BE-së, në njërin anë, dhe i Shteteve të Bashkuara në anën tjetër, shihet si komplementar, pra që përplotësojnë njëra-tjetrën.

Kosova do të jetë një partnere e besueshme dhe serioze me të gjithë këta faktorë të rëndësishëm globalë përgjatë gjithë procesit”, ka thënë Murtezaj. Ai ka deklaruar se Kosova i ka të qarta parimet dhe objektivat që synon t’i arrijë në këtë proces. “Lidhur me dialogun, Kosova ka treguar përkushtimin për këtë proces të rëndësishëm, i cili duhet ta përfshijë njohjen reciproke dhe normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Po ashtu, është kërkuar që procesi i vendimmarrjes për liberalizimin e vizave të ndodhë sa më shpejt sepse Kosova ka përmbyllur të gjitha detyrat e saj që lidhen me këtë proces”, është shprehur Murtezaj.

“Epoka e re”: Z. Murtezaj, është

mbajtur Samiti i Parisit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili ka shënuar në njëfarë forme rifillimin e dialogut në mes të këtyre dy vendeve. Cilat pritet të jenë efektet e këtij samiti?

Murtezaj: Takim i nivelit më të lartë, Samiti i Parisit, i mbajtur më 10 korrik, i udhëhequr nga presidenti francez Makron dhe kancelarja gjermane Merkel dhe, po ashtu, nga zyrtarët e lartë të BE-së, Borrel dhe Lajcak, ishte një takim shtytës për rifillimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Ky takim vjen pothuaj pas një ndërprerje për 18 muajsh. Takimi ka pasur qellim ofrimin e një ambienti për shpalesjen e qëndrimeve dhe pritjeve nga palët dhe nga ndërmjetësit. Pas këtij takimi pritet që dialogu gradualisht të marrë rrjedhën e vet, si një proces për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kosova nga ky dialog pret njohjen e shtetësisë së saj. Qëndrimi i qartë i kryeministrit të Kosovës është që ky dialog nuk po fillon tani, dialogu ka filluar më parë dhe tani është koha për t’u përmbyllur dhe që rezultati final duhet të jetë njohja e shtetësisë së Kosovës. Përndryshe, i gjithë ky

proces nuk do ta kishte kuptimin e duhur dhe efektin e duhur.

“Epoka e re”: Kur pritet të mbahet takimi mes kryeministrit Hoti dhe presidentit të Serbisë në Bruksel dhe çfarë do të bisedohet në këtë takim?

Murtezaj: Si rezultat i takimit virtual të Parisit, të datës 10 korrik, të organizuar nga presidenti francez Macron dhe kancelarja gjermane Merkel, më datë 12 do të ketë një takim virtual të Brukselit. Aty pritet të prezantohen idetë për procesin e dialogut për të ardhmen, qëndrimet e Kosovës në këtë proces, si dhe pritjet nga dialogu, që për Kosovën është njohja e shtetit të Kosovës.

“Epoka e re”: Paraprakisht kryeministri Hoti ka realizuar një vizitë në Francë, ku është pritur nga presidenti francez. Çfarë do të thotë për Kosovën ky takim?

Murtezaj: Ishte një takim i nivelit më të lartë. Gjithçka e organizuar rreth këtij takimi, përfaqësimi, pritja dhe prania e nivelit më të lartë shtetëror francez, kanë bërë që kjo vizitë e kryeministrit Avdullah Hoti të jetë vizita më e lartë bilaterale e Kosovës dhe Francës në 10 vjetët e fundit. Takimi ishte shumë i mirë, biseda e ngrohtë dhe miqësore. Ishte

ET TË PËRMBYLLET KËTË VIT



takim gjithëpërfshirës, ku presidenti Macron ishte shumë i afërt, i hapur dhe i drejtpërdrejtë për të gjitha çështjet e diskutuara.

“Epoka e re”: Çfarë është diskutuar konkretisht në këtë takim?

Murtezaj: Janë diskutuar shumë tema. Duke filluar nga perspektiva evropiane e Kosovës, liberalizimi i vizave, dialogu dhe bashkëpunimi Kosovë - Francë. Kryeministri i Kosovës i ka prezantuar presidentit francez perspektivat, brengat dhe gjithçka që lidhet me Kosovën në fazën që po kalon. Për më tej, Kosova është e vendosur t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për perspektivën e saj evropiane, si e vetnja mundësi për paqe, stabilitet dhe prosperitet të kësaj pjese të Evropës. Lidhur me dialogun, Kosova ka treguar përkushtimin për këtë proces të rëndësishëm, i cili duhet ta përfshijë njohjen reciproke dhe normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Po ashtu, është kërkuar që procesi i vendim-marrjes për liberalizimin e vizave të ndodhë sa më shpejt sepse Kosova ka përmbyllur të gjitha detyrat e saj që lidhen me këtë proces.

“Epoka e re”: Siç po shihet, ShBA-ja dhe BE-ja e kanë marrë më

seriozisht çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Cilat janë pritjet e qeverisë për këtë proces. Brenda çfarë periudhe kohore mund të kemi një marrëveshje të mundshme?

Murtezaj: Procesi nuk duhet të zgjasë pafund, përkundrazi kryeministri Hoti ka kërkuar që dialogu të përmbyllet gjatë vitit 2020. Sidoqoftë, ky proces është kompleks dhe kemi të bëjmë me sjellje destruktive të Qeverisë së Serbisë. Prandaj ndihma e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian është e rëndësishme së pazëvendësueshme.

“Epoka e re”: Si e sheh Qeveria e Kosovës rolin e ShBA-së në këtë proces, meqenëse BE-ja, konkretisht Franca dhe Gjermania, kanë marrë një rol prijës?

Murtezaj: Për Kosovën bashkëpunimi evropian dhe amerikan është jetik. Në këtë proces roli gjerman dhe francez nga ana e BE-së, në njërin anë, dhe i Shteteve të Bashkuara në anën tjetër, shihet si komplementar, pra që përplotësojnë njëra-tjetrën. Kosova do të jetë një partnere e besueshme dhe serioze me të gjithë këta faktorë të rëndësishëm globalë përgjatë gjithë procesit.

Kosova dhe Serbia kanë rifilluar bisedimet me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian (BE)

Hoti dhe Vuçiqi do të takohen më 16 korrik

Kosova dhe Serbia janë pajtuar që më 16 korrik të ndodhë takimi ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel. Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për këtë proces, Miroslav Lajçak, ka thënë se pajtimi ka ndodhur në takimin mes palëve që është mbajtur të dielën në formë virtuale. Ai ka falënderuar palët për angazhimet konstruktive



shteteve nuk ka alternativë. “Dialogu nuk ka alternativë. Dhe vetëm përmes dialogut mund t'i zgjidhim çështjet me Serbinë. Në të gjitha takimet e deritashme kam propozuar platformën e dialogut. Ne në këtë proces hyjmë vetëm për njohjen reciproke dhe normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të dy vendeve”, ka thënë Hoti, duke treguar për kohën e takimit të ardhshëm. “Sot kemi arritur pajtueshmëri në parim, ta kemi takimin e radhës në Bruksel, të enjten që vjen, që është takimi i parë pas 20 muajsh që është ndërprerë dialogu”, është shprehur Hoti.

Disa ditë më parë Kosova dhe Serbia kanë diskutuar në një video-konferencë të organizuar nga presidenti francez Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane Angela Merkel dhe aty u pajtuan për rifillimin e bisedimeve, por nuk pajtuan në asnjë pikë për rrugët e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet të dyja palëve.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë mbajtur edhe një takim në formë virtuale të dielën të ndërmjetësuar nga BE-ja. Pas këtij takimi, përfaqësuesi i posaçëm i BE-së, Miroslav Lajçak, ka thënë se është arritur pajtueshmëri për agjendën e takimit të radhës në Bruksel, i cili do të mbahet më 16 korrik. Ai ka treguar se Hoti dhe Vuçiqi janë pajtuar që bisedimet të vazhdojnë edhe të enjten, më 16

korrik. “Jam i lumtur të them se pas Samitit të Parisit dhe takimit të sotëm midis Kosovës dhe Serbisë, dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve është kthyer në rrugë të drejtë pas 20 muajsh. Si rezultat i takimit të sotëm ne u pajtuam për elementet kryesore të procesit dhe agjendës së takimit tonë të radhës që do të mbahet të enjten në Bruksel. Falënderoj partnerët për angazhimin konstruktiv”, ka thënë Lajçak pas takimit virtual ndërmjet dy delegacioneve. Takimi më 16 korrik ndërmjet kryeministrit Hoti dhe presidentit Vuçiq do të mbahet

në Bruksel. Shefi i politikës së Jashtme i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, para fillimit të takimit, ka thënë se bisedimet synojnë një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht detyruese për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja palëve. “Një marrëveshje e tillë është thelbësore për të ardhmen më të mirë për qytetarët e Kosovës dhe Serbisë, është thelbësore për të ardhmen e tyre evropiane, për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rajonit. Por, tërë kjo është, po ashtu, thelbësore për Bashkimin Evropian”, ka deklaruar ai, duke

theksuar se nuk është një punë e lehtë, por është emergjente që të punohet për paqen e përparimin për hir të së ardhmes së përbashkët. “Kjo detyrë kërkon guxim politik nga të dyja palët. Kërkon përkushtim dhe angazhim në frymën e kompromisit dhe pragmatizmit”, ka deklaruar Borrell. Takimin e së enjtes e ka konfirmuar edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti. Në një konferencë për media, ai ka thënë se Kosova është e gatshme për këtë proces, duke shtuar se për Qeverinë e Kosovës dialogu në mes të dy

Zgjatet për një vit misioni i EULEX-it në Kosovë

PRISHTINË, 12 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, janë pajtuar për zgjatje teknike njëvjeçare të mandatit të misionit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Zgjatja teknike më së voni deri më datën 14 qershor 2021, sipas një komunikate për media të presidencës, thuhet se po bëhet pasi që pandemia ka pamundësuar negociatat për të ardhmen e mandatit të EULEX-it. "Në letërkëmbimin e tij, presidenti Thaçi ka shprehur gatishmërinë që në mënyrë që ta sigurojmë vazhdimësinë e

Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë ('EULEX KOSOVA') gjatë këtyre rrethanave të jashtëzakonshme, Kosova pajtohet për një zgjatje teknike të EULEX KOSOVA, më së voni deri më datën 14 qershor 2021", thuhet në njoftimin e Presidencës.

Përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Josep Borrell, sipas kësaj komunikate, thuhet se pranon këtë pajtueshmëri për zgjatje teknike njëvjeçare të EULEX Kosovo deri më 14 qershor 2021 dhe thekson mbështetjen e BE-së për Kosovën, me theks të veçantë të mbështetja në këto kohë të "sfidave të paprecedencë" të shkaktuara nga pandemia.



Mandati i EULEX-it është negociuar çdo dy vjet dhe gradualisht është zvogëluar mandati dhe janë bartur

kompetencat tek organet vendore. Bazuar në vlerësimet e organizatave joqeveritare në Kosovë, misioni i BE-së nuk i ka

përmbushur pritjet, sidomos në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

EULEX Kosova ka filluar në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje.

Misioni i tashëm i EULEX-it është t'i asistojë autoritetet e Kosovës në ngritjen e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura të sundimit të ligjit.

Misioni vazhdon t'i mbështesë Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.


Bashkësia Islame e Kosovës, me masa për parandalimin e Covid-19

PRISHTINË, 12 KORRIK - Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) ka bërë publike disa masa për parandalimin e përhapjes së koronavirusit. Ndërkohë, kanë kërkuar nga autoritetet kompetente që të mos marrin vendim për mbylljen e xhamive. Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, në një adresim publik tha se Bashkësia Islame është e përkushtuar të bashkëpunojë me të gjitha institucionet për ta ruajtur shëndetin publik. Myftiu tha se kanë marrë vendim që, përveç të tjerash, të

bëhet pezullimi i mësim-besimit dhe shkollës verore në të gjitha xhamitë e Kosovës, të moshuarit mbi moshën 65-vjeçare, të rinjtë nën moshën 16-vjeçare dhe të sëmurët kronikë të falen në shtëpi. Po ashtu, Tërnavë ka bërë me dije se besimtarët obligohen të mbajnë maska në xhami. Numri i përgjithshëm i të infektuarve me Covid-19 në Kosovë deri të shtunën ka arritur në 4 715 nga 27 723 teste të bëra, ndërsa janë shënuar 101 raste të vdekjeve.



Policia ndalon 11 persona për shkeljen e masave kundër Covid-19



PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës ka ndaluar njëmbëdhjetë persona nën dyshimin se kanë shkelur rregullat e vendosura nga autoritetet e Kosovës për luftimin e pandemisë Covid-19. Masat e reja për luftimin e Covid-19 kanë hyrë në fuqi më 6 korrik.

Shumica e rasteve të ndalimit të këtyre personave ka të bëjë me mosrespektimin e orarit të

lëvizjes gjatë pandemisë.

Në raportin 24-orësh të Policisë së Kosovës thuhet se policia ka marrë masa ndaj pronarit të një lokali ku po mbahej një aheng familjar, në të cilin kishin qenë të tubuar rreth 130 pjesëmarrës, e që është në kundërshtim me masat për parandalimin e përhapjes së koronavirusit.

Që prej 6 korrikut, në Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Vushtrri është ndaluar lëvizja e

qytetarëve nga ora 21:00 deri në orën 5:00. Në këtë interval kohor e kanë të ndaluar ta ushtrojnë aktivitetin e tyre edhe bizneset e gastronomisë.


Në Kosovë, që prej regjistrimit të rasteve të para me koronavirus më 13 mars e deri më 11 korrik, numri i përgjithshëm i të infektuarve ka arritur në 4 715 nga 27 723 teste të bëra, ndërsa janë shënuar 101 raste të vdekjeve.

"Epoka e re" i shpreh ngushëllime familjes Buzhala për vdekjen e Bashor Buzhalës

PRISHTINË, 12 KORRIK - Gazeta e përditshme "Epoka e re" i ka shprehur ngushëllime familjes Buzhala për vdekjen e Bashor Buzhalës. Në telegramin ngushëllues të gazetës, thuhet se familja Buzhala në Prishtinë, e tëra e përfshirë, përballoi me qetësi dhe dinjitet të lartë betejën me virusin Korona për disa javë në izolim, duke inspiruar të tjerët për

respektimin e rregullave dhe për shmangien e panikut. "Si kolegë dhe si njerëz, bashkëndiejmë thellë me Beratin dhe familjarët e tjerë për humbjen e të zotit të shtëpisë, Bashor Gegë Buzhala. 'Epoka e re' i shpreh ngushëllimet më të sinqerta kolegut Berat Buzhala dhe të gjithë familjarëve e farefisit. Familja Buzhala në Prishtinë, e tëra e

përfshirë, përballoi me qetësi dhe dinjitet të lartë betejën me virusin Korona për disa javë në izolim, duke inspiruar të tjerët për respektimin e rregullave dhe shmangien e panikut. I ndjeri u prehtë në paqe, ndërsa familjarëve Zoti u dhashtë durim dhe forcë përballë dhimbjes!", është thënë në telegramin ngushëllues të gazetës "Epoka e re" drejtuar familjes Buzhala.



Aktakuza, dëshmia në Hagë dhe tri qëndrime ndaj çështjes Thaçi

Bedri ISLAMI

Pas tronditjes së parë dhe qëndrimeve më shumë emocionale, çka ishte e natyrshme dhe e pritshme, tani vjen koha e qëndrimit serioz, të thelluar dhe duke menduar për vështirësitë që mund të dalin nga aktakuza e Prokurorit të Specializuar ndaj disa figurave të njohura të luftës dhe të politikës në Kosovë, mes të tjerëve, të cituar nga njoftimi zyrtar, edhe presidenti Thaçi, Kadri Veseli, lideri i PDK-së, forca politike e dalë në fillimet e saj nga luftëtarët e lëvizjeve çlirimtare, sidomos nga Lëvizja Popullore e Kosovës, dhe të tjerë, emrat e të cilëve janë një enigmë e lënë qëllimisht në hije, jo vetëm për t'i ngjallur të papriturat, por që i gjithë faji, sipas prokurorit, të rëndojë në dy figura të njohura.

Kanë qenë e mbeten tre qëndrime ndaj çështjes Thaçi, nëse mund ta quaj kështu, ashtu si ka edhe tri mundësi në vazhdimin e saj. Qëndrimi i parë ishte ai i bashkëpunëtorëve dhe bashkëluftëtarëve të tyre, të cilët, ashtu si edhe në raste të tjera, ndihen të tradhtuar, pasi e gjithë godina që është ngritur nga vetë Kuvendi i Kosovës, ku Thaçi dhe Veseli ishin determinues, që ndjek, heton dhe akuzon vetëm shqiptarët, u duket dhe është monstruoze dhe e pajustificuar. Për 178 të vrarë apo të zhdukur realë nga shqiptarët e Kosovës është NJË shtetas me kombësi serbe apo i supozuar si bashkëpunëtor i tyre. Është një raport përmblyës, që synon pa asnjë dyshim të ndryshojë atë që ka ndodhur në Kosovë dhe që ngjalloi reagime të pamasa në botën mediale.

Reagime të tilla ka pasur dhe do të ketë edhe në raste të tjera, ku figura të njohura të luftës janë akuzuar dhe burgosur, qoftë në struktura ndërkombëtare, rasti Haradinaj, rasti Limaj, ku nga gjashtë të akuzuar u "gjet" fajtor vetëm një luftëtar që nuk ishte në asnjë hierarki ushtarake, por edhe kur janë akuzuar apo dënuar në Kosovë nga struktura ndërkombëtare, si rasti i drejtuesve të luftës në zonën operative të Llapit, në zonën operative të Drenicës apo me figura të njohura nga zona operative e Dukagjinit.

Në fakt, janë hetuar, akuzuar dhe dërguar për gjykim liderë nga tri zonat ku ka pasur më shumë luftime, ku masakrat serbe kanë qenë më të mëdha dhe në të cilat janë bërë akte të pashembullta të kimit të organizuar shtetëror serb, por edhe nga paraushtarakë të cilët menduan se po u jepnin dëbimin e fundit bashkëvendësve të tyre.

Në kohën kur shteti serb ngre padi dhe dërgon mijëra faqe për rreth

100 të humbur, analistë kontroversë në Shqipëri e katërfishojnë numrin e tyre, duke e akuzuar UÇK-në për rreth 400 serbë të zhdukur, sikur ata të ishin pjesë e kancelarisë së Beogradit, si pjesë mediale e tyre.

Qëndrimi i dytë ishte ai i kundërshtarëve politikë të Thaçit, në Shqipëri apo në Kosovë. Disa me mllef të habitshëm, dhe jo rastësisht ata, edhe në të shkuarën kanë qenë pjesë e strukturave kundër luftës çlirimtare, dhe të tjerë me cinizmin politik që mendojnë se i afrojnë me pushtetin.

Thaçi, Veseli apo të tjerë, nuk do të gjykojnë për mendimin e tyre politik e as për debatet që kanë bërë me kundërshtarët e tyre politikë; ata nuk do të mund të merren të akuzuar se kanë qenë pjesë e korrupsionit politik apo financiar në Kosovë, gjithnjë nëse është e vërtetuar; askush nuk do të hetojë për mënyrën se si ata janë bërë drejtues të UÇK-së, por, dhe kjo është thelbi i gjithçkaje, për krime të supozuara që kanë ndodhur gjatë dhe në vitin e parë të pasluftës.

Në Tiranë, për fat të keq, por jo e papritur, ish drejtuesi i PD-së, Berisha, kur është menduar se në fund të fundit do të gjente mënyrën e reagimit të tij përmes heshtjes, bëhet zëdhënës i një rryme politike që e dërgon drejt atyre që edhe mohojnë luftën e zhvilluar. Ka qenë e pritshme, pasi ai, Thaçi, është kundërshtar politik i Berishës dhe mes tyre ka qenë e ndezur një luftë akuzash që nuk i bëri nder askujt, pasi, jo vetëm ishin të vonuara, por nuk ndryshonin asgjë nga ajo që dihej. Në Kosovë kundërshtarët ndaj presidentit Thaçi njihen, ata e kërkuar me ngulm arrestimin e tij, lobuan për këtë aktakuzë, gjithnjë me shpresën e pushtetit, njëjtë si kishin bërë që në ditët e luftës aleatët e tyre të djeshëm politikë, me të cilët u ndanë sepse nuk mund të bashkoheshin.

Nëse në dosjet e paraqitura një ditë do të ketë informacione nga organizata "Sigurimi i Atdheut", apo nga "militantët" opozitarë, askush nuk pse habitet nga kjo. Mllef i njerëzror është edhe mllef politik dhe nuk merr parasysh asgjë tjetër. Shërbimi që i kanë bërë rrjedhshëm pushtetit të dëbuar serb përmes strukturave misterioze është i mjaftueshëm për të qenë në një ditë të nesërme, të dënuar, në mos tjetër, historikisht.

Analistë, të njohur si grupi anti Ramë, janë bërë zëdhënës të qëndrimit anti Thaçi, jo se e dinë të vërtetën, megjithëse disa prej tyre kanë akses të mjaftueshëm në materialet e strukturave të posaçme të Serbisë, por, më tepër se kaq, ata kanë qenë për përmbyshjen e Thaçit me çdo kusht, duke dërguar radikalizmin



në Kosovë dhe mbështetur Kurtin, të cilin, një ditë të ardhshme, nëse gabon e afrohet me Ramën, do i hidhen sipër me të njëjtin mllef.

Përgjithësisht ky grupim analistësh, që edhe gjatë luftës ishin cinik, përtallës, mburraveçë dhe ndonjëri prej tyre lehtësisht i shihsëm, që një ditë mbështet opozitën, sidomos kur është thellësisht radikale dhe ditën tjetër e sulmon, kur mendon se po bëhet më e arsyeshme, pas dënimit të Thaçit shohin edhe rënien e Ramës.

Nuk shohin dhe as duan të ia dinë se çfarë humbet Kosova nga ky mllef, çfarë është e vërteta, çfarë në fakt ka ndodhur dhe si ka ndodhur.

Ata e perceptojnë luftën si një shëtitje në katet e larta të lokaleve komfortë dhe modernë, ku mund të diskutohet duke pirë kafe dhe duke gjykuar si të ishin marshallë të njohur të luftës.

Qëndrimi i tretë, kësaj here zyrtar, ishte ai i shtetit shqiptar, që, aq sa ishte butaforik dhe emocional, aq ishte edhe i padobishëm. Pas duartrokitjeve parlamentare ka më shumë se një zemërim, dhe, nëse do të ishin bërë detyrat e shtëpisë që nga mbarimi i luftës për sqarimin e akuzave që lidhen me ngjarje në territorin shqiptar, atëherë shumë gjëra do të kishin qenë më të dobishme.

A është fajtor Hashim Thaçi?

A është fajtor Kadri Veseli?

A janë fajtorë "të tjerët", si thuhet në njoftimin e prokurorit të Specializuar?

A është e saktë enigma se i gjithë zinxhiri komandues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është i hetuar, i listuar dhe mund të jetë një ditë i akuzuar?

Akuza ndaj tyre a do të jetë edhe akuzë ndaj vetë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe përpjekjeve në disa dekada të shqiptarëve të Kosovës që të jenë të mosvarur, të lirë, për një jetë të denjë?

Lufta nuk ka qenë fillimi i gjenocidit në Kosovë, por akti i fundit i tij.

Që nga fundi i vitit 1944 dhe deri në qershorin e vitit 1999, pra në disa dekada, të vrarët shqiptarë nga shovinizmi serbomadit është mbi 60 mijë vetë. Më pas se një e

treta u vranë gjatë luftës. Pasuria e grabitur, qoftë përmes pronave, por edhe e pagesa të kontributeve pensionale është në disa dhjetëra miliardë euro. Mijëra vetë janë përdhunuar, grabitur dhe zhdukur.

Carla del Ponte, edhe kur ishte kryeprokurore e shtetit zviceran, ishte njëra ndër kundërshtarët më të egra ndaj pavarësisë së Kosovës; është e vetmja në të gjithë shtetet evropiane që ndaloi me ligj veprimtarinë mbështetëse ndaj luftës dhe viktimave dhe, në fund, pasi nuk arriti të provojë asnjë nga akuzat e saj, më tepër politike, la pas vetes një libër të turpshëm, tek i cili po mbështeten, mjerisht, edhe njerëz të politikës dhe të mediave në Shqipëri.

Sido që të trajtohet nga kancelaritë evropiane aktakuza ndaj disa figurave të njohura, pra, edhe kur theksohet se ajo është për individë të veçantë dhe jo për UÇK-në, ajo, jo tërthorazi, por drejtpërdrejtë rëndon mbi këtë të fundit.

Ka mjaft njerëz në Kosovë, mes tyre edhe miq të mi, të shumë dekadave, sidomos në vite të vështira, që nuk janë të këtij mendimi, që nuk e kanë njohur kurrë Thaçin si drejtues të Ushtrisë Çlirimtare, megjithëse kanë bërë pjesë në një organizatë dhe këtë nuk e kanë bërë tani, por që në krye të herës, kur lufta ende nuk kishte filluar.

Ata, megjithëse të paktë, janë respektuar në qëndrimet e tyre, i kanë shtruar këto probleme haptas, disa herë me shkrim, sepse kanë qenë pjesë e një lëvizje të hapur nga mendimi dhe qëndrimet, e megjithëse strukturat e larta drejtuese nuk i kanë miratuar, përsëri janë në të drejtën e tyre të qëndrojnë në këtë mendim. Vendimet e strukturave drejtuese të luftës, si Këshilli i Përgjithshëm dhe kryesia e LPK-së, nuk mund të hidhen poshtë e të lihen anash nga ngjarjet që kanë ndodhur.

Por Thaçi, Veseli e të tjerë nuk do të hetohen, akuzohen e ndoshta gjykojnë se kanë qenë apo jo realë në pozicionet që kanë pasur.

Ata, në sytë e botës politike e mediale ndërkombëtare, por edhe tek të tjerë, kanë qenë drejtues të strukturave të larta të UÇK-së,

anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, të Drejtorisë Politike, drejtues politikë dhe ushtarakë, dhe përmes këtij pozicionimi do të trajtohen.

Nëse naivisht mendohet se bota politike e juridike do të ndajë luftën e zhvilluar përmes dy strukturave, kjo është dëshirë vetjake, por jo realitet politik.

Askush nuk e di se çfarë aktakuze është ngritur ndaj të tjerëve, të cilët mund të jenë po ashtu drejtues të lartë, ndaj Thaçit dhe Veselit.

Vetë Thaçi do ta mësojë në fillimin e javës së ardhshme, kur do të pyetet nga gjykatësi special.

Askush nuk e di se si është perceptuar ajo pjesë e hetimit që ka të bëjë me veprimtarinë e Kadri Veselit, të luftëtarëve të tjerë, emrat e të cilëve pas disa kohësh do të jenë të njohur dhe njerëzit do të mësojnë se kjo nuk është më punë me dy a tre vetë, që nuk do të ishin domethënia e UK-së, por me disa nga figurat, pa të cilat nuk mund të ketë histori të luftës.

Personalisht unë besoj në pafajësinë e Hashim Thaçit! Personalisht unë besoj në pafajësinë e Kadri Veselit!

Personalisht unë besoj në pafajësinë e "të tjerëve", pavarësisht se cilët është përpjekur të fshehtë prokurori i Specializuar!

Jo vetëm se jam mik i tyre dhe kam qenë pjesë e strukturave të larta politike të luftës, por sepse i gjithë programi, mendimi, qëndrimi i UÇK-së ka qenë kundër dhunës. Në majin e vitit 1998 heroi i Kosovës, Fehmi Lladrovci, duke dhënë intervistë në BBC do të deklaronte haptas se, "Le të tregojnë pushtetarët serbë një rast të keqtrajtimit të tyre...ne armët nuk i kemi marrë kundër popullsisë civile, por kundër makinerisë vrasëse të Millosheviqit..."

Në shkurtin e vitit 1999, në Rambuje, pala serbe paraqiti një listë me vetëm pesë civilë të zhdukur, nga të cilët tre jetojnë ende, megjithëse kanë masakruar të popullsisë civile shqiptare.

Jam i prirur të besoj në pafajësinë e gjithë luftëtarëve të UÇK-së!

Ngutja për t'i shpallur fajtorë apo të pafajshëm, për të bërë rolin e hetuesit, prokurorit apo gjykatësit, në mos tjetër është delikuençë mendore dhe qytetare; është rendje pas një fakti që mund të mos jetë i tillë dhe mbështetje për akuzën që mund të jetë e rreme.

Nëse nesër do të bëhen publike gjithë materialet e dërguara nga shteti serb kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, askush të mos habitet kur mes mijërave e mijërave faqeve do të gjejë edhe shkrime mediale, deklarata politike, akuza monstruoze, pa asnjë fakt por mbi hamendje, pikërisht nga "të zemëruarit" e sotëm të Tiranës apo një skotë në Kosovë.

BISEDË ME KRYETARIN E SINDIKATËS SË SEKTORIT PRIVAT, JUSUF AZEMI

Azemi: Gjendja e punëtorëve privatë është rënduar



Kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka thënë se gjendja ekonomike dhe sociale e punëtorëve të sektorit privat është vështirësuar. Ai ka thënë se në momentin e fillimit të pandemisë Covid-19 kanë kërkuar që pagat e punonjësve në sektorin shtetëror të ulen në 50 për qind dhe të stimulohen punëtorët e sektorit privat, të cilët, sipas tij, asnjëherë nuk e kishin vëmendjen e shtetit. “Nuk e di se deri kur do të zgjasë kështu, por shteti duhet të jetë i barabartë për të gjithë”, ka thënë Azemi

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka thënë se gjendja ekonomike dhe sociale e punëtorëve të sektorit privat trefish është vështirësuar nga fillimi i pandemisë Covid-19. Në këtë bisedë për gazetën “Epoka e re”, Azemi ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk e ka hallin e gjendjes dhe vështirësive me të cilat po përballen punëtorët në këtë sektor. Ai ka bërë thirrje që të miratohet buxheti në mënyrë që punëtorët ta marrin shumën prej 170 eurosh. “Gjendja e punëtorëve në sektorin privat është e rëndë, sidomos në këtë

kohë pandemie kur është trefishuar gjendja e vështirësive. Në fakt, Qeveria e Kosovës nuk ka krijuar ndikimet e veta për stimulim dhe lehtësim të punëtorëve në sektorin privat. Sa i përket pakos emergjente, pjesa dërrmuese e këtyre mjeteve s’kanë shkuar në vendin adekuat. E kam fjalën për kompensimin e punëtorëve. Një pjesë e madhe e këtyre mjeteve kanë shkuar në vende të ndryshme dhe ne si sindikatë ia kemi tërhequr vërejtjen ish-ministrit, por edhe ministres së tanishme të Financave. Ka punëtorë që janë duke punuar dhe nuk e kanë marrë pagën e prillit, majit dhe qershorit. Është një gjendje që nuk po shohim një dritë në fund

të tunelit”, ka deklaruar Azemi. Ai ka thënë se është paturpësi e madhe se si deputetët e Kosovës nuk e votuan buxhetin dhe e pamundësuan marrjen e pagesës prej 170 eurosh për punëtorët e sektorit privat. “Është një paturpësi e madhe që individët që kanë mirëqenie të lartë jetësore, siç janë deputetët, nuk çajnë kokën për punëtorët e sektorit privat. Po të kishte qenë edhe një shtet armik këtë gjendje s’do ta lejonte me punëtorët e sektorit privat që të kërkojnë lëmshohë të njëri-tjetri. Ata e zvarrisin çështjen e votimit të buxhetit dhe punëtorët e sektorit privat mbesin pa paga”, është shprehur Azemi. Ai ka theksuar se duhet të zgjatet

afati i ndihmës për punonjësit e sektorit privat. “Vendimi është që të kompensohen punëtorët e sektorit privat vetëm për muajin mars dhe prill. Ne kemi kërkuar që për punëtorët që janë në rrezikshmëri të punës të vazhdohet ndihma edhe për muajin maj dhe qershor, sidomos për punëtorët që kanë të bëjnë me Qendrën e Mjekësisë Familjare, punëtorët teknikë të cilët bëjnë sigurimin e këtyre objekteve, por sa do të aprovohet kërkesa jonë, mbetet të shohim. Por, meqenëse pandemia është në vazhdim dhe rreziku është i lartë, atëherë mendoj se qeveria në mënyrë obliguese duhet ta zbatojë këtë dhe, po ashtu, ta zgjasë ndihmesën edhe për muajt në vazhdim”, u shpreh tutje Azemi.

Sipas tij, shteti nuk është duke i mbrojtur të drejtat e punëtorëve në sektorin privat. “Shteti nuk është duke e mbrojtur të drejtën e punëtorëve. Janë duke u larguar nga puna shumë punëtorë. Ne kemi bërë kërkesë edhe në inspektorat. Numri i punëtorëve

të sektorit privat është 270-300 mijë, por në sistem s’besoj që janë as 200 mijë të cilëve u paguhet trusti dhe obligimet e tjera ndaj shtetit. Ne protesta kemi bërë në mënyrë individuale dhe në këtë kohë nuk parashohim protesta për shkak të pandemisë”, ka deklaruar ai.

Azemi ka thënë se është e kuptueshme gjendja e rënduar në buxhetin e shtetit por, sipas tij, shteti duhet të jetë i barabartë për të gjithë. “Në momentin e fillimit të pandemisë kemi kërkuar që pagat e punonjësve në sektorin shtetëror të ulen në 50 për qind dhe të stimulohen punëtorët e sektorit privat të cilët asnjëherë s’kishin vëmendjen e shtetit dhe janë në rrezikshmëri të vazhdueshme, sepse janë aktivë në punë, përderisa punëtorët e sektorit publik po qëndrojnë nëpër shtëpitë e tyre dhe po ruajnë familjen, kurse ne duhet të punojmë për ta. Nuk e di se deri kur do të zgjasë kështu, por shteti duhet të jetë i barabartë për të gjithë”, ka deklaruar në fund Azemi.

Oda Ekonomike Amerikane alarmon për gjendjen ekonomike në vend

Prishtinë, 12 korrik - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) u ka bërë thirrje partive politike që ta shmangin diskursin konfliktiv dhe rrënimin e prospekteve të rimëkëmbjes ekonomike. Në një komunikatë për media, OEAK-u thekson se diskursi thellësisht

përçarës politik brenda institucioneve dhe jashtë tyre pengon arritjen e konsensusit nacional dhe tejkalimin e vështirësive të krijuara pas shpërthimit të pandemisë Covid-19. Oda Ekonomike Amerikane alarmon se në muajt në vijim do

të shpërfaqen pasojat reale në aspektin ekonomik e social për shkak të mbijetesës së vështirësuar të një numri të ndërmarrjeve, kryesisht të vogla dhe të mesme. “Vonesat e mëtejme në aprovimin e ndryshimeve të kornizës buxhetore, por edhe të

marrëveshjeve financiare ndërkombëtare, do ta vonojnë disbursimin e mjeteve të zotuar në ndihmë të ndërmarrjeve dhe punonjësve të sektorit privat, që janë shtylla e zhvillimit ekonomik të vendit”, thuhet në komunikatën e OEAK-ut.

Mekanizmat financiarë ndërkombëtarë në raportet e tyre të publikuara për efektet e pandemisë në ekonominë e Kosovë kanë vlerësuar se janë shkaktuar dëme të mëdha. Banka Botërore në raportin e saj ka paraparë një rënie ekonomike prej 4.5 përqindësh në Kosovë.

Gërxhaliu: Kemi varrosje të ekonomisë

Sekretari gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, Safet Gërxhaliu, ka apeluar që assesi mos të ketë mbyllje për ekonominë e vendit, por të ketë masa penalizuese në rast të mosrespektimit të masave kundër Covidit



ndihmën e merituar dhe ka mbetur pa mbështetje institucionale. Vërtet kemi varrosje të ekonomisë”, ka thënë Gërxhaliu.

Ai ka folur për sektorët të cilët

nuk bën të mbyllen. “Ndërtimtaria, komunikacioni dhe gastronomia, të gjithë sektorët duhet të jenë të lirë. Duhet të kemi masa penalizuese sesa të dëmtohet ekonomia dhe

të dhe të jemi njollë e zezë në arenën ndërkombëtare, sepse titujt e gazetave evropiane po flasin për një infektim të përmasave të gjëra”, është shprehur Gërxhaliu.

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 KORRIK - Sekretari gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë se, edhe nëse shpallet gjendje e jashtëzakonshme, ekonomia e vendit assesi nuk duhet të mbyllet. Në këtë bisedë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se kryeministri Hoti nuk duhet të marrë vendime pa koordinim me sektorin privat. Sipas tij, më mirë është të ketë masa penalizuese dhe vetëdijesuese sesa të varrosset ekonomia e vendit. “Meqë është duke u shqyrtuar mundësia e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë dhe nëse merret një

vendim i tillë, do të jetë në dëm të ekonomisë së vendit. Në mediat ndërkombëtare Kosova është shndërruar në njollë të zezë. Mbi 20 gazeta evropiane shkruajnë se në Kosovë mbi 50 për qind e popullsisë është infektuar. Dua të besoj se kryeministri Hoti nuk do të marrë një vendim të tillë pa koordinim me dialogun ekonomik dhe social. Në këtë drejtim më mirë është të ketë penalizime për ata që nuk mbajnë maska, të ketë distancë dhe pastërti. Mbyllja e ekonomisë do të kishte efekte negative. Në vendet evropiane dhe të rajonit përdoret buxhet shtetëror për mosfalimentim të sektorit privat, kurse Kosova është në pozitë të palakmueshme sepse sektori privat nuk e ka

Bizneset kërkojnë shtyrje të kësteve për kredi, BQK-ja thotë se ka bërë një zgjidhje shumë më të mirë

PRISHTINË, 12 KORRIK - Edhe pse komuniteti i biznesit dhe qytetarët në vazhdimësi kanë kërkuar shtyrjen e kësteve për kredi edhe për tre muaj, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka nxjerrë një udhëzues për bankat komerciale që varësisht nga aftësia paguese e klientit ta kenë mundësinë të bëjnë riprogramimin e kredive, duke llogaritur edhe interesat. Ndërsa Qeveria e Kosovës vazhdon të heshtë dhe të mos i përkrah bizneset në mbulimin e interesave.

Për dallim nga Kosova, disa vende të tjera kanë mundësuar që të shtyhen sërish pagesat e kësteve të kredisë. Kryetari i Bordit të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skënder Krasniqi, ka thënë për “Kosovapress” se shtyrja e kësteve për kredi është e domosdoshme për bizneset sepse, sipas tij, kompanitë dhe qytetarët do të kenë vështirësi t’i paguajnë normat e interesit dhe këstet në këtë kohë pandemie. Krasniqi ka thënë se bizneset janë në gjendje të rëndë, pasi që përballen me vështirësi për qasje në financa dhe kështu rrezikohen edhe të falimentojnë.

“Me fillimin e pandemisë bankat kanë ndërprerë edhe dhënien e kredive të rregullta

dhe ende nuk kanë filluar të japin kredi. Pastaj kërkesë është shtyrja e pagesave dhe kësteve për kredi për ata që kanë nevojë. Por, kërkohej shtyrje e kësteve edhe për kamatat e tatimeve që është më se e nevojshme. Interesin për këtë shtyrje ta marrë përsipër shteti dhe të mos i alokohet biznesit dhe qytetarëve, sepse me fillimin e pagesës bizneset dhe qytetarët do të kenë vështirësi shumë të mëdha të pagesës së kredive. Do të jetë një ngarkesë për biznesin si dhe do të rrezikohet edhe falimentimi i bizneseve dhe rritja e papunësisë”, ka thënë Krasniqi.

Në anën tjetër, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë për “Kosovapress” se kanë bërë një zgjidhje më të mirë sesa që është shtyrja, e që është e veçantë me anë të një udhëzimi për riprogramimin e kredive.

Mehmeti ka shtuar se bankat komerciale janë duke lëshuar kredi edhe në kohë të pandemisë. “Kemi bërë një zgjidhje shumë më të mirë sesa që është shtyrja, e që është e veçantë marrë parasysh që kemi marrë edhe rekomandimet e FMN-së se si të veprojnë bankat gjatë pandemisë dhe pas pandemisë me qëllim që ta përkrahin sektorin e ekonomisë në tërësi. Dhe në këtë kontekst,



ne kemi përgatitur një udhëzim të cilin e kemi aprovuar dhe ua kemi dërguar bankave si udhëzues, me qëllim që bankat, varësisht nga aftësia paguese e klientit, ta kenë mundësinë ta bëjnë ristrukturimin apo riprogramimin e kredive pa pasur nevojë për provizione shtesë. Prandaj, ky është një përfitim i dyanshëm si për bankat, për arsye se as për bankat nuk është interes që të

kenë kredi të këqija. Duke marrë parasysh që nëse rriten kreditë e këqija bankat duhet të ndajnë kapital për këtë. Por, njëkohësisht edhe për kompanitë që, gjithashtu, t’i paguajnë këstet sipas mundësive që i kanë ose nëse paraqitet nevoja, edhe për grejs periudhë e kështu me radhë”, ka thënë Mehmeti. Ai ka shtuar se BQK-ja ka qenë një ndër institucionet e para në vend që ka reaguar në

pandemi dhe në koordinim edhe me Shoqatën e Bankave janë shtyrë për tre muaj këstet nga 16 marsi deri më 16 qershor.

Për dallim nga Kosova, disa vende të tjera kanë mundësuar që të shtyhen sërish pagesat e kësteve të kredisë. Në Shqipëri është dhënë mundësia që pagesat e kësteve të kredive të mund të shtyhen edhe tre muaj të tjerë, duke bërë një shtyrje për 6 muaj.


Diskutohet për gjendjen e bizneseve në Kamenicë

KAMENICË, 12 KORRIK (ER) - Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë në Kamenicë ka mbajtur takimin e radhës,

në të cilin është diskutuar për situatën e krijuar nga Covid-19. "Në takim u diskutua rreth situatës së komunitetit të biznesit të

krijuar nga Covid-19, gjithashtu u përgatitën rekomandime për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë (DZhed). Përveç

anëtarëve të komitetit, pjesëmarrës ishte edhe një përfaqësues nga DZhed", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.



Tahiri thotë se pandemia ka ndikuar që sivjet toka të punohet më shumë në Vushtrri



VUSHTRRI, 12 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se ka filluar fushata e korrje-shirjeve në këtë komunë.

Me këtë rast, Tahiri ka theksuar se këtë vit, për shkak të pandemisë, toka është punuar më shumë nga fermerët vushtrrias. "Korrje-shirjet kanë filluar në

Vushtrri. Në këtë kohë të vështirësisë me Covid-19 na gëzon fakti se rendimenti i grurit është i kënaqshëm për fermerët. Pandemia ka bërë që më shumë

të punohet toka këtë vit, pra do të ketë më shumë prodhimtari bujqësore. Faleminderit fermerëve që prodhojnë produkte cilësore vendore! Këtë

pandemi do ta kalojmë më lehtë edhe për shkak të punës së vyer të fermerëve vushtrrias", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Fillon fushata e korrje-shirjeve në Deçan

DEÇAN, 12 KORRIK (ER) - Komuna e Deçanit ka njoftuar se ka filluar fushata e korrje-shirjeve në këtë komunë. Drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë, Rifat Stojkaj, ka treguar se në territorin e komunës së Deçanit do të korren mbi 260 hektarë grurë. "Sot bashkë me kolegët nga Drejtoria e Bujqësisë kemi dalë në terren për ta parë nga



afër fillimin e sezonit të korrje-shirjeve të grurit për vitin 2020 në vendin tonë. Kemi vizituar fermerët Ramadan Sokolaj nga Pozhari dhe Hasim Mazrekaj nga Prejlepi, duke u uruar një vit me plot bereqet. Ky vit ka qenë specifik që kemi kaluar me pandeminë, me mbylljen e kufijve dhe bizneseve dhe kur përballemi me këto situata, e

kuptojmë se sa e rëndësishme është që ne të kemi prodhues dhe bujq të vjeshëm lokalë sikurse në Komunën e Deçanit. Shpresoj të kemi rendiment të pëlqyeshëm të grurit për sivjet. Ministria e Bujqësisë edhe këtë vit do ta vazhdojë subvencionimin e grurit duke përfshirë edhe pjesën e grandeve", ka thënë Stojkaj.

Komuna e Shtimes bën dezinfektimin e institucioneve dhe hapësirave publike

Shtime, 11 korrik - Në kuadër të zbatimit të masave për parandalimin e pandemisë Covid-19, Komuna e Shtimes ka filluar dezinfektimin e hapësirave publike në terri-

torin e kësaj komune. Kjo komunë ka bërë me dije se dezinfektimi është bërë në institucionet komunale, QKMF, Stacionin e Policisë, Qendrën e Punës Sociale, në

rrugët kryesore, sheshin si dhe rrugicat në qytetin e Shtimes për të vazhduar me rrugët e fshatrave. "Komuna e Shtimes masat parandaluese është duke i zbatuar në për-

pikëri dhe për zbatimin e tyre është duke u përkujdesur Shtabi Komunal për Menaxhimin e situatës me Covid-19", ka njoftuar Komuna e Shtimes.



PA UÇK-në DHE LUFTËN E SAJ ÇLIRIMTARE KOSOVA KTHEHET NË NJË PARCELË TË GJITHKUJT (5)



Shkruan: Kudusi LAMA

Milloseviqi ndërmori të gjitha monstruozytet por, pa sukses, u përballë me Jasharët e Mëdhenj, me Prekazin, me Glogjanin, me Drenicën, me Dukagjinin, me Llapin e Gollakun, me Nerodimen, me Sharrin, me Pashtrikun, me Rugovën, me Anamoravën e Anadrininë etj. Megjithatë, përsëri iu dha leje në verën e vitit 1998, përsëri në tetor, në dhjetor, edhe në janar 1999, përsëri në shkurt... E nuk pati më kohë se djemtë e UÇK-së nuk u mposhtën, ata do të ishin çdo ditë më të fortë. Detyrimisht iu mbarua uji Milloseviqit. Ai tashmë nuk kishte asnjë mundësi për t'u përballur me UÇK-në. Në betejë hyri bota moderne, por tashmë jo kundër UÇK-së, por kundër Milloseviqit. Kam besuar se për të vendosur drejtësi, por po krijoi idenë se ajo ndërhyrje ishte për ta shpëtuar Serbinë tashmë pa Milloseviqin, që ishte konsumuar për politikën ndërkombëtare. A mund të jetë kjo e vërtetë?

Por çfarë ndodhi më tej? Në fillim UÇK-ja u vlerësua me nota shumë të larta, si forcë tokësore e NATO-s, që duke bashkëpunuar me të, NATO-ja edhe nëse do të kishte nevojë për forca tokësore, nuk do të ishte nevoja sepse do të shfrytëzohej UÇK-ja që ishte në terren e që i plotësonte të gjitha kriteret. Më e shumta që mund të bëhet për këtë, do të duhej të armatosej me disa armë moderne. Kush ka dëshirë të marrë informacion më të gjerë për këtë, le t'u referohet librave të presidentit Bill Clinton "Jeta ime", sekretares së shtetit Medlein Ollbrajt "Zonja sekretare", komandantit të NATO-s gjeneralit Uesli Clatk "Të bësh luftë moderne" etj. Në të gjitha është e thënë gjithçka qartë.

Por lufta mbaroi dhe në plan të parë doli çmilitarizimi i UÇK-së, si kusht për mirëkuptim në rrugën e bërjes së Kosovës së pavarur. U pranua me besim, por më duket se paska qenë me hile. Pas çmilitarizimit të UÇK-së, doli se TMK-ja si trashëgimtare e saj nuk duhet të ketë armë, por duhet të jetë si një forcë logjistike. U pranua edhe kjo si mirëkuptim. Por ja

që u kërkua të kalohej në Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe këto duhet të ishin shumetnike. Por realisht cili është roli i NATO-s sot në Kosovë? Ajo e përfaqësuar nga KFOR-i, pretendon të jetë këshilluese për Forcat e Sigurisë së Kosovës, por nuk e njeh pavarësinë e Kosovës e, për rrjedhojë, nuk e njeh shtetin e Kosovës. Kjo forcë konstruktive në vitin 1999, nuk di si mund të qëndrojë akoma me mendësinë e vitit 1999. Si duhet ta kuptoj këtë? A nuk duhet ta kuptoj si një hile për shqiptarët dhe për Kosovën në veçanti? Për mua kjo forcë do të duhej të kishte përgatitur deri tani forcat e Armatosura të Kosovës që do të jenë nesër luftarake e do të bëhen anëtare të NATO-s. Deri tani nuk është punuar fare për t'i përgatitur forcat ushtarake të Kosovës me standardet e nënrepartëve ose repartëve të NATO-s, sepse nesër ajo forcë do të jetë ushtria që do të jetë garantë e sigurisë dhe krenarisë së Kosovës. Ky është një tregues i qartë i faktit se këtu po qëndrohet hiq e mos këput siç i themi ne shqiptarët. Mirëpo me hiq e mos këput nuk ndërtohet jeta kombëtare e shtetërore, pasi ne do të jemi këtu jetë pas jete deri në fund. Prandaj pretendojmë se nuk është mirë të shkojmë me mendimin "le të kalojë edhe dita e sotme". Unë kam pretendime, pasi jam i gatshëm të bëj sakrificë për

ndershmerinë. Por jo sakrificë duke lëshuar pozicionin e arritjeve kombëtare.

Pikërisht këto janë hapat që duke i hedhur një nga një, Serbia arriti deri aty, sa pa bërë asnjë kërkim faljeje për krimet që ka kryer, po na akuzon se ne jemi kriminelët që paskemi bërë krime mbi serbët. Prokurorët specialë ndërkombëtarë për krimet në ish-Jugosllavi, ngritur me vendim të OKB-së, mbështetur në dëshmitë e Serbisë dhe agjentëve të saj, na arrestuan mjaft prej djemve të luftës si kriminelë lufte, na i dënuan pa asnjë fakt e mjaft prej tyre fituan pafajësinë.

Dhe tani akuza ndaj UÇK-së për krime lufte hyri edhe në politikë. I zgjedhuri i Evropës për t'i bërë akuzat në interes të Serbisë ishte një zviceran që kishte qenë përkrahës i flaktë i Serbisë dhe kundërshtar i egër i luftës çlirimtare të Kosovës. Ky akuzues politik tashmë nuk do të bënte akuza për vrasje, por për kanibalizëm. Ai do ta akuzonte Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në tërësi dhe udhëheqësit e saj në veçanti, se kur ishin në vijat e frontit, nuk e kishin mendjen se si do të mund të arrinin të fitonin mbi pushtuesin serb, por se si mund të siguronin ndonjë serb të shëndetshëm që të mund t'i merrnin organet për t'i shitur diku. Nuk e di nëse njerëzit normalë do ta konsiderojnë një

ndjesi të tillë si të mundshme në këto situata, kur në Kosovë ishin jo pak, por mbi 72 mijë ushtarë e policë, me detyrë të asgjësonin shqiptarët. Po kështu edhe 63 mijë serbë civilë të armatosur, mbi 8 mijë paramilitarë, mbi 5 mijë kriminelë e disa qindra agjentë të UDB-së, të cilët çdo ditë luftonin me forcat e UÇK-së dhe vrisnin e masakronin qytetarë të paarmatosur dhe sot secili prej tyre është dekoruar mbi tri herë nga Beogradi, pikërisht pse ka vrarë e masakruar shqiptarë në shtëpitë e tyre. Këto forca kishin në dispozicion edhe disa qindra tanke, disa dhjetëra helikopterë luftarakë, disa dhjetëra aeroplanë gjuajtës-bombardues, disa qindra gryka zjarri artilerie të kalibrit të madh, qindra raketa kundërtanke me një përdorim dhe disa dhjetëra raketa që shpërndanin secila në një sipërfaqe 1 hektar, 298 granata të cilat shpërthenin rreth një metër mbi sipërfaqen e tokës etj. Dhe mbi këto, krimet i kanë bërë luftëtarët e UÇK-së, që kanë pasur vetëm armë krahu dhe kanë qëndruar përballë këtij arsenali serb.

Sidoqoftë, duhet të vlerësojmë se tashmë kemi një akuzë dhe përballë saj duhet të jemi aktivë për të sqaruar gjithçka e për të bërë që opinioni të kuptojë se janë këto akuza një abuzim, apo janë të vërteta.

Vetëm në asnjë mënyrë nuk duhet ta ngatërrojmë luftën që është e shenjtë, me pretendimet që mund të kemi për qeveritarët e sotëm. Unë do të kërkoja prej të gjithëve që të distancohen nga këto kombinime. Pasi duket se është organizuar mirë aktiviteti antishqiptar, për ta krijuar idenë se këto që na qeverisin sot, ishin kriminelë para se ta merrnin pushtetin në Kosovën e çliruar. Ashtu sikurse po punohet që duke sjellë pengesa në qeverisje e në rritjen e mirëqenies së qytetarëve kërkohet që qytetarët ta krijojnë mendimin se ishin më mirë nën Milloseviqin se sa sot që janë të lirë. Këtë mesazh po tentojnë ta japin edhe serbët, ashtu edhe segmente të ndryshme evropiane, e shumë mbështetës e mbrojtës së interesave serbe, duke krijuar pamje nga më të pakuptueshmet për portretin e shqiptarëve. Dhe kjo duke përdorur atë "përkëdheljen" për shqiptarët, duke thënë "ne i duam shqiptarët, ne duam thjesht luftëtarët e UÇK-së t'i kriminalizojmë, sepse nuk mund të bëjmë çfarë duam në Kosovë, në qoftë se do t'i kemi ata nëpër këmbë". Këtë duhet ta kuptojnë qytetarët e Kosovës, intelektualët dhe politikanët. Të mos bien në kurthin e përkëdheljeve të atyre që duan ta përbaltin UÇK-në dhe luftën e saj. Duhet ditur se pa UÇK-në dhe luftën e saj çlirimtare



Presidenti Trump, për herë të parë me maskë në publik

NJU JORK, 12 KORRIK - Shtetet e Bashkuara kanë shënuar një rekord të ri prej 66 mijë rasteve të reja me koronavirus. Në mesin e shteteve më të goditura janë: Kalifornia, Teksasi dhe Florida - tri shtetet më të populluara. Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka vizituar një spital ushtarak të shtunën, ku është parë për herë të parë duke mbajtur maskë. Ai më parë ishte kritikuar për mosmbajtje të maskës gjatë takimeve me zyrtarë në Shtëpinë e Bardhë dhe gjatë paraqitjeve publike. Vizita e tij vjen pasi Shtetet e

Bashkuara janë në një periudhë të vështirë dhe sfiduese të luftës kundër koronavirusit. Më shumë se 3.2 milionë persona në Shtetet e Bashkuara janë të infektuar me virusin Covid-19, derisa 134 000 kanë humbur jetën. Anthony Fauci, drejtor i Institutit Kombëtar të ShBA-së për Alergjia dhe Sëmundje Infektive, ditë më parë ka thënë se rritja e numrit të të infektuarve dhe viktimave vjen pasi shumë shtete të ShBA-së filluan rihapjen e bizneseve dhe lehtësimin e urdhrave të qëndrimit në shtëpi përpara se të shihnin një ngadalësim të shkallës së infeksionit.



Paralajmërojnë ekspertët britanikë: Vala e dytë e Covidit do të vijë kur temperaturat të bien



LONDËR, 12 KORRIK - Rritja e numrit të të infektuarve ka shtuar frikën e rikthimit të një vale të dytë të Covid-19. Sipas ekspertëve britanikë të shëndetësisë, vala e dytë e koronavirusit do të mbërrijë

kur temperaturat të bien në 4 gradë celsius në dimër. Ata shtojnë se një gjë e tillë mund të çojë në një mbyllje të dytë të vendit, e kjo në kohën kur ekonomia e goditur rëndë prej pandemisë sapo ka

nisur të marrë veten. Sipas tyre, besohet gjerësisht se virusit i "pëlqen" temperatura 4 gradë celsius, e kjo mund ta shpjegojë përhapjen e shpejtë të tij në shkurt e mars. "Për momentin mund ta

kalojmë më lehtë se është verë, por është e rëndësishme që njerëzit të përgatiten për sfidat që do të sjellë dimri", u shpreh një anëtar i grupit Këshillimor Shkencor për Emergjencat në Britania.

DASH: Shtetasit amerikanë në Kinë të tregojnë kujdes të shtuar

NJU JORK, 12 KORRIK - Departamenti Amerikan i Shtetit ka paralajmëruar shtetasit amerikanë në Kinë që "të tregojnë kujdes të shtuar" për shkak të rritjes së rrezikut që ata të ndalohen arbitrarisht ose të mos lejohen të largohen nga vendi. "Shtetasit amerikanë mund të ndalohen dhe të mos kenë qasje në shërbimet konsullore ose të mos u komunikohet informacioni për veprën e pretenduar kriminale", ka njoftuar Departamenti i Shtetit në

një paralajmërim për shtetasit amerikanë në Kinë. Departamenti i Shtetit ka njoftuar se shtetasit e ShBA-së mund të përballen me "marrje të zgjata në pyetje" dhe me ndalime të zgjata "për arsye që lidhen me sigurinë shtetërore". "Personeli i sigurisë mund të ndalojë dhe ose dëbojë shtetasit e ShBA-së për dërgim mesazhesh elektronike private, që kritikojnë qeverinë kineze", thuhej në njoftimin e DASH-it, pa përmendur shembuj konkretë. Departamenti i Shtetit,



gjithashtu, nuk thotë se çfarë u bë shkak për nxjerrjen e paralajmërimit në fjalë. Njoftimi vjen ndërkohë që janë shtuar tensionet e dyanshme mbi çështje si pandemia Covid-19, tregtia, ligji i ri i sigurisë për Hong Kongun dhe akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut kundër ujqurëve në rajonin Sinkiangut. Kohët e fundit Uashingtoni dhe Pekini shpallën ndalime vizash për zyrtarë të njëri-tjetrit, një shenjë tjetër e keqësimit të marrëdhënieve.

Presidenti iranian: Nuk mbyllemi më, s'e përballojmë dot



TEHRAN, 12 KORRIK - Presidenti i Iranit, Hassan Rouhani, ka deklaruar se vendi i tij nuk do të shkojë më në karantinë. "Situata jonë ekonomike nuk na e lejon një mbyllje të dytë", u shpreh Rouhani. Më shumë se 12 400 veta kanë

ndërruar jetë në republikën islamike që prej fillimit të epidemisë. Irani ishte një nga vendet që u godit më rëndë prej koronavirusit që në fillimet e sëmundjes dhe e vuri shpejt karantinën, të cilën e hoqi më pas në muajin prill.

Por tani vendi po përjeton një shtim të ndjeshëm të rasteve dhe vetëm të enjten, bilanci ditor i vdekjeve shkoi në 221. Rouhani thotë se, pavarësisht situatës së rënduar shëndetësore, një tjetër rrezik madhor i kanoset vendit, e ai

është kolapsi ekonomik. Për këtë arsye, e bëri të qartë se iranianët duhet t'i vazhdojnë aktivitetet e tyre ekonomike dhe sociale, por duke respektuar ndërkohë në maksimum protokollet e shëndetit.

Mueller mbron hetimin ndaj Ruisë: Stone kreu krime federale

NJU JORK, 12 KORRIK - Ish-prokurori i Posaçëm Robert Mueller ka mbrojtur hetimin që ai ka kryer mbi lidhjet e mundshme mes Ruisë dhe zyrtarëve të fushatës presidenciale të Donald Trumpit

gjatë vitit 2016, në një opinion të publikuar të shtunën në gazetën "Washington Post". Ai shkruante se hetimi kishte një "rëndësi thelbësore" si dhe pohonte se aleati i Trumpit, Roger

Stone, "mbetet një shkelës ligji i dënuar", pavarësisht vendimit të presidentit për t'ia ulur atij dënimin. Opinioni i publikuar në "Washington Post" shënon deklaratën e parë publike të

Muellerit mbi hetimin që nga paraqitja e tij përpara Kongresit korrikun e kaluar. Ajo përfaqëson mbrojtjen e tij më të fortë të hetimit dyjeçar, rezultatet e së cilës janë sulmuar shpesh.



Drama e përditshme e shqiptarit në 'Ëndrra, shi dhe lule'


Qendresa RAMA

Poeti Fadil Halimi në fund të muajit maj të këtij viti ka botuar librin me poezi "Ëndrra, shi dhe lule". Ky libër është i ndarë në katër cikle: Shi dhe lule (Stinë dashurie), Plumba (Plumba dhe shi), Shi dhe ëndrra (Libri i mosdurimit) dhe Karantina (Cikli i fundit), në të cilët ka përmbledhur disa tema të përditshme, eternale, të zakonata, të pazakonta dhe të papritura, siç janë ditët e izolimit të qytetarëve me vendim qeverie, të cilat autori, bashkë me qytetarët e tjerë, i përjeton si ditë lufte, madje bën një raport krahasimi me luftën e fundit në Kosovë, me granatimin e serbëve ndaj shqiptarëve.

Me këtë lloj të shkrimit (poezinë) Halimi ka thënë mjaft të pathëna dhe ka thurur mjaft veçanti artistike në vargje. Duhet ta kemi parasysh se këtë lloj të shkrimit, shfaqur për publikun, Halimi e ka nisur që në vitet nëntëdhjetë, kur botonte poezi në revistën "Jeta e re".

Në këtë libër, pra në "Ëndrra, shi dhe lule", në këtë "trinom poetik", me 54 poezi autori ka bashkuar në një libër, njëkohësisht ndarë në katër cikle, disa sekuenca nga drama e përditshme e njeriut, çastet e gëzimit dhe të hidhërimit e të pikëllimit të tij. Padyshim se në të e gjejmë atë që e ka thënë në parathënie Imer Topanica, se vetë titulli "Ëndrra, shi dhe lule" na sugjeron një lloj leximi të tillë semantik, duke na paralajmëruar se nëpërmjet ëndrrës mund ta takojmë shpresën; nëpërmjet shiut, trishtimin; nëpërmjet metaforës së lules, dashurinë. "Gruaja, atdheu, nëna, babai, motrat, i biri etj., vijnë si trajta simbolikash nëpërmjet të cilave vihet gurthemeli i këtij kodi tematik", ka shkruar Topanica në parathënie të librit, duke rrokur me këtë fjali elementët kryesore të librit.

Ndërkaq recensenti i parë i librit, Ahmet Selmani, ka veçuar toposin lirik të librit, duke shprehur se në këtë



Vet titulli "Ëndrra, shi dhe lule", na e sugjeron një lloj leximi të tillë semantik, duke na paralajmëruar se nëpërmjet ëndrrës, mund ta takojmë shpresën, nëpërmjet shiut, trishtimin, dhe nëpërmjet metaforës së lules, vet dashurinë.

Imer Topanica

Poezia e Fadil Halimit është e koncentruar brenda një kryemetafore, siç është stina e dashurisë, e cila rrezaton semantikën e gjerë artistike. Në fakt, kemi të bëjmë me një topos lirik, me një rrafsh shpirtëror, ku ndodh mishërimi dhe trazimi emocional për gjërat e shtrenjta, siç janë: njerëzit e afërt, e dashura, nëna, babai, vogëlushi, miqtë etj.

Ahmet Selmani

Fadil Halimi shkruan rrallë. Shkruan vetëm atëherë kur i shkruhet. Atëherë kur përnjëmend ka për të thënë diçka, pa fshehur dot si ndrydhje shpirti apo blasfemi heshtjeje. Vargu i tij sublimon jetën përtej jetësh.

Xheladin Rexhepi

ISBN 978-9951-06-798-0



9 789951 067980

libër poetik "kemi të bëjmë me një rrafsh shpirtëror, ku ndodh mishërimi dhe trazimi emocional për gjërat e shtrenjta siç janë: njerëzit e afërt, e dashura, nëna, babai, vogëlushi, miqtë".

Ndërkaq recensenti tjetër i librit, Xheladin Rexhepi, ka

thënë se poezia e Halimit dallon nga arketipi i motiveve libreske, pa gjak, pa imagjinatë dhe fabul. "Kultivon një formë shprehëse poetike të lirshme, të dendur, si në aspektin motivues, ashtu edhe në metrikën e zgjedhur përtej skemave klasike", ka konstatuar Rexhepi.

PESË POEZI NGA LIBRI "ËNDRRA, SHI DHE LULE"

VENDI I ZBRAZËT I NANËS

Çast pafuqie e trishtimi
me u nda prej nanës
e me e pa me sy fluturimin e saj

Frymë e saj e mbramë jeton në mue
me erën e bukës
me mërzinë dhe dhimbjen e pafund

Nanë, askush si sytë e tu magjike
nuk kanë ditë me e çelë zemrën teme
e me i shnoshë dhimbtë

Afër teje, nanë
Gjithnji ndodhin gjana të bukura

MBRETANIA E VDEKJES

Si nëpër flakë pushke
kemi dalë nga mbretëria e vdekjes
dhe baladat

Në hijen e ankthit
sa herë kemi dhanë shpirt
jemi ringjallë si feniks

Përsëri kemi provue
me fluturue hapësinave të shpirtit
e me vizatue lirinë e imagjinuesë

MORTJE

Nuk jemi kërkah, lum miku
Përsëri kemi mbetur në fund të tunelit
Ku po shuhet edhe drita e fundit

Në këto net të verbëta mallkimi
Edhe mortja i ka prekur ëndrra tona
E na ka heshtur e vetmuar si në balada

Sytë na janë zmadhuar nga trishtimi
Sikur e kemi harruar sëmundjen e rëndë

Prapa perdeve të mashtrimit
Fati im e fati yt sërish po shkruhet
Me alfabet të panjohur

Lum miku,
A s'e sheh se na ka marrë lumi

NATA E FUNDIT NË KARANTINË

(Një natë e gjatë në karantinë)

Nata më e gjatë në karantinë
I ringjall fotografitë e frikshme
Të plumbave që binin si shiu

Nga ankthi e ëndrrat e llahtarshme
Lëkundej tërmeti i shtëpisë
Si një tërmet në shpirtin e vranë

Hijet e natës stërzgaten
Dhe përgjojnë në dhomën e vetmisë

Mallkimi bie si rrufe
në fluturimin qiellor
për t'i ngjallur përvjetorët e vdekjes

E dashur
Ishte kjo një ëndërr e keqe,
Apo një histori e përsëritur

Ç' RENDËSI KA SI VDISET

Nuk ka rëndësi si jep shpirt
Duke e shikuar qiellin, apo me sy mbyllur

S'ka rëndësi
Nëse vdes
Me mallin e një përqaftimi
të shpirtave
të mbetur
në këtë botë bizare

Nuk ka rëndësi
As diagnoza e sëmundjes
Sa malli për të ecur
Për të fundit herë
Hapësirave të shpirtit të nënës e të babës

E për të vazhduar
Lojën e fshehtë të fëmijërisë
Me motrat e mbetura në vetmi
Në degën e këputur të pemës

E jashtëzakonshme

Kinezi shpallet i vdekur, shfaqet në shtëpi dy muaj më vonë



Kinezi Jiao (43), kur mjekët e shpallën si të vdekur, u kthye në shtëpi i gjallë, gjë që tronditi familjarët e tij. I ndjeri u shfaq

te dera e shtëpisë dy muaj pasi familja mbajti ceremoninë e varrimit. Jiao, i cili ka një sëmundje mendore, u zhduk

nga shtëpia e tij në qytetin jug-perëndimor Chongking në mars, tha xhaxhai i tij, i njohur me mbiemrin Liu.

FOTO E DITES



Si pasojë e përmbytjeve në Hitoyoshi në Japoni një makinë qëndron vertikalisht në një rrugë me baltë. / AP/

BARSOLETA E DITËS



Mjeku: Çfarë halli të ka sjellë këtu?
Plaku: Po ja më dhëmb këmba e majtë.
Mjeku: Sa vjeç jeni?
Plaku: 87.
Mjeku: Është normal në këtë moshë të keni ndonjë shqetësim të vogël.
Plaku: 87 vjeçe është edhe këmba e djathtë, por nuk më ka sjellë kurrë shqetësime.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

E rrallë

Miliarderi rus ndërton akullthyesen e parë private në botë



Biznesmeni rus Oleg Tinkoff ka thënë se është i gatshëm ta japë me qira akullthyesen e tij private që ka kushtuar 80 milionë euro, e pajisur me pista helikopteri, dhomë masazhi, mjete lëvizëse në akull dhe një nëndetëse të



thellësive. Anija e tij mund të merret me qira nga dashamirësit e aventurës për 740 000 euro në javë. Mjeti 77 metra i gjatë quhet La Datcha. Është prodhuar në kantieret Damen Yachting, i porositur nga 52-vjeçari Tinkoff, i cili është themelues i "Tinkoff Bank".



DASHI

Askush nuk po ju pengon në rrugën tuaj. Ju jeni vetë përgjegjës për jetën tuaj dhe është koha që të kuptoni se keni më shumë pushtet sesa keni menduar ndonjëherë.



DEMI

Dikush në familjen tuaj ka kaluar kohët e fundit një ndryshim jete që ju ka bërë ta shikoni jetën në mënyra të ndryshme.



BINJAKËT

Kalojeni mëngjesin duke organizuar pjesën tjetër të ditës dhe shpejt do të shihni disa mënyra të thjeshta për të krijuar më shumë kohë të lirë pasdite.



GAFORRJA

Qëndroni me objektivat tuaja dhe mos u dorëzoni në shenjën e parë të telasheve. Çfarëdo pengese që hasni do të jetë argëtuese.



LUANI

Nëse dikush dëshiron të nisë një fillim të ri nesër, mund të jetë një lëvizje mjaft e mirë. Ndoshta në një moment pozitiv për fillimet e reja.



VIRGJËRËSHA

Fokusi në jetën tuaj duhet të vazhdojë të jetë në marrëdhënien sentimentale. Në mënyrë të veçantë, kjo është një ditë e mrekullueshme për një pajtim.



PESHORJA

Ndoshta ka ardhur momenti për të nisur një raport dashuror që do të sillte më shumë oksigjen brenda jush.



AKREPI

Roli juaj brenda grupit po bëhet gjithnjë e më i madh dhe më i rëndësishëm. Kjo mund t'ju bëjë të mendoni se jeni përgjegjës për lumturinë e njerëzve të tjerë.



SHIGJETARI

Kërkesa juaj për të mbrojtur dikë do të bëhet më e fuqishme, por jini të kujdesshëm në lidhje me mënyrën se si i qaseni situatës.



BRICJAPI

Vendosni më shumë rend në jetën tuaj sentimentale. Nëse nuk tregoni angazhimin e duhur, mund të përfshihen në një keqkuptim të madh.



UJORI

Mbajeni fokusin në një marrëdhënie, një projekt shkollor apo një afat pune, nesër nuk është dita për t'i shtyrë punët deri në çastet e fundit.



PESHQIT

Ju mund ta ktheni një ditë frustrimi dhe sikleti në një ditë të ndriçimit dhe të të mësuarit, por vetëm nëse hiqni dorë nga krenaria e kotë. Mos u tregoni arrogant.

Brooklyn Beckham fejohe me të dashurën Nicola Peltz



Djali i madh i çiftit të famshëm anglez të shoubizit, David e Victoria Beckham, 21-vjecari Brooklyn, është fejuar me të dashurën 25-vjeçare Nicola Peltz. I apasionuari

i fotografisë u ka treguar për vendimin miqve dhe sipas raportimeve, prindërit David, 45-vjeçar dhe Victoria, 46-vjeçare, kanë dhënë bekimin e tyre për zhvillimin e martesës.

Covid-19 “falimenton” aktorin



Shumë po humbin para nga Covid-19. Në këtë listë bën pjesë dhe ylli i kinemasë, Robert de Niro. Aktori i famshëm hollivudian rrëfeu se pandemia i ka dhënë një goditje të fortë zinxhirit të restoranteve të tij Nobu dhe hotelit “Greenwixh”, të cilët prej muajsh janë mbyllur pjesërisht. Në prill, Nobu humbi tre milionë dollarë në maj, edhe 1.87 milion të tjera duke e

detyruar de Niron të merrte hua sepse nuk kishte likuiditetin e nevojshëm për të paguar një grup investitorësh. Nga ana tjetër dhe ish-bashkëshortja e tij, Grace Hightower, me të cilën aktori ka qenë i martuar për 11 vjet deri kur nisën procedurat e divorcit në vitin 2018, u ankua në gjykatë se ylli hollivudian i kishte reduktuar shumë e parave që duhet t’i paguajë.



Bebe Rexha në lidhje dashurie? Dalin fotot e para

Këngëtarja e njohur shqiptare, Bebe Rexha, ka qenë gjithmonë e hapur për publikun, mirëpo jetën private e ka mbajtur të rezervuar. Derisa të gjithë mendonin se është ‘single’, “DailyMail” ka publikuar disa

imazhe të Bebes me një mashkull misterioz. Dyshja që dukeshin shumë të afërt thuhet se u fotografuan në hyrje të një tregu të ushqimeve. Akoma nuk dihet identiteti mes këtij mashkulli e as detaje të tjera rreth marrëdhënies së tyre.

Eminem bën thirrje të përdoren maskat



Reperi i njohur amerikan Eminem ka bërë thirrje që të respektohen rekomandimet e OBSH-së për bartjen e maskave. “Gjysma prej nesh ecin thjesht

rrugëve dhe nuk duan të bartin maska”, ka thënë Eminem në tekstin e një kënge. Kjo këngë ka ardhur bashkëpunim me reperin amerikan Kid Cudi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita merr një pikë të artë në Prishtinë

Drita ka marr një pikë të artë në ndeshjen kundër Prishtinës (1-1), e cila mund të jetë vendimtare në garën për titull. Tri pikë ka rrëmbyer të dielën Gjilani ndaj Drenicës (2-0), derisa katër ndeshjet e tjera të javës së 30-të, zhvillohen sot (e hënë) nga ora 17:00



marrë edhe tri pikë të reja nga përballja me kuqezinjtë e Drenicës. Keita Razak ishte realizator i të dy golave për Gjilani në pjesën e parë të ndeshjes. Rastet nuk munguan në pjesën e dytë, por gola të tjerë nuk pati. Pas tri pikëve të reja, Gjilani e ka rrëmbyer përkohësisht pozitën e dytë me 61 pikë, derisa Drenica ka bërë një hap pas në garën për mbijetesë, dhe zë vendin e tetë me 38 pikë. Sot (e hënë)

zhvillohen katër ndeshjet e tjera në Superligë. Përballja kryesore pritet të zhvillohet në Drenas në mes kampiones në fuqi, Feronikelit dhe skuadrës së Ballkanit. "Nikli" ka humbur gjasat për titull, derisa skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi kërkon tri pikë nga kjo ndeshje dhe vazhdimin e garës me Dritën, Prishtinë dhe Gjilani. Llapi që ishte deri vonë në garë për titull, tash është duke e rrezikuar mbijetesës. Kjo

skuadër e pret në stadiumin "Zahir Pajaziti" skuadrën e Flamurtarit, e cila poashtu kërkon pikët e mbijetesës. Për fitore në Klinë udhëton edhe Trepça '89, e cila përballlet me Dukagjinin që tashme ka siguruar rënien në Ligën e Parë. Ndeshje me pak interesante pritet të jetë ajo në mes Vushtrrisë dhe Ferizajt, pasi të dyja këto skuadra tashme edhe zyrtarisht kanë rënë nga Superliga.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

Superligë, pasi të dielën arriti fitore ndaj Drenicës me rezultat 2-0. Klubi nga Gjilani, pas fitores në ndeshjen e kaluar kundër Prishtinës (2-1), ka arritur të

IPKO Superliga		
Prishtina - Drita	1-1	
Gjilani - Drenica	2-0	
Të hënën takohen:		
17:00 Feronikeli - Ballkani		
17:00 Llapi - Flamurtari		
17:00 Dukagjini - Trepça '89		
17:00 Vushtrria - Ferizaj		
Tabela		
		PIKË
1. Drita	30	65
2. Gjilani	30	61
3. Ballkani	29	59
4. Prishtina	30	58
5. Feronikeli	29	44
6. Flamurtari	29	41
7. Llapi	29	39
8. Drenica	30	38
9. Trepça '89	29	35
10. Ferizaj	29	26
11. Vushtrria	29	18
12. Dukagjini	29	10

PRISHTINË, 12 KORRIK - Ndeshja derbi në mes Prishtinës dhe Dritës përfundoi pa fitues (1-1). Përballja mes dy skuadrave që po luftojnë për titull në Superligë ishte mjaftë interesante. Në minutën e gjashtë, Prishtina realizoi pas një kundërsulmi nëpërmjet Endrit Krasniqit. Rastet për shënim në pjesën e parë kishin edhe Januzi dhe John, por nuk i konkretizuan në gol. Edhe Drita pati rastet e veta për shënim, por Fazliu, Vucaj dhe Haxhimusa nuk arritën të barazojnë rezultat. Edhe pjesa e dytë ishte mjaftë interesante, derisa Drita e barazoi rezultat në minutën e 80-të, kur nga afërsia realizoi Astrit Fazliu, për rezultat final 1-1. Ky barazim i ka konvnuar Dritës që tash ngritet në kuotën e 65 pikëve, kurse Prishtina zë vendin e katërt me 58 pikë. Ndërsa skuadra e Gjilanit e vazhdon garën për titull në IPKO

Veronika Kastrati: Kam synime të mëdha me Raelingenin



PRISHTINË, 12 KORRIK - Hendbollistja e Përfaqësueses së Kosovës, Veronika Kastrati, ka bërë hap të rëndësishëm në karrierë. 18-vjeçarja i është bashkuar klubit norvegjez Raelingen, i cili është i njohur për zhvillimin e lojtareve të reja. Veronika është larguar nga klubi Ellingsrud, ku ishte prej fillimit të karrierës, prej moshës 9-vjeçare. "Unë kam filluar të luaj hendboll qysh në moshën 9-

vjeçare në Ellingsrud IF. Kam luajtur aty me vajzat e lindura në vitin 2001. Si 16-vjeçare kam luajtur për senoret në ligën e tretë të Norvegjisë. Deri më tani isha në të njëjtin klub. Kam marrë pjesë në shumë tubime të reprezentacionit regjional të grupmoshave U18 e U20 dhe në shumë tubime të talenteve të Norvegjisë", ka thënë Kastrati për faqen zyrtare të FHK-së. "Jam shumë e kënaqur me

përzgjedhjen e ekipit. Kam pasur shumë oferta nga klube të tjera, por kam vendosur për Raelingen, që është klub i mirë, ka trajnerë dhe staf shumë profesional. Ekipi U20, ku do të luaj fillimisht, garon në kategorinë e dytë të Norvegjisë. Por nëse rezultatet sportive tregohen të mira, qëllimi im dhe i klubit është që të bëhem pjesë e ekipit elitare që garon në elitën e Norvegjisë", ka shtuar Kastrati.

Hamiltoni triumfon në Austri, pilotët e Ferrarit përplasen mes vete

ZELTWEG, 12 KORRIK - Lewis Hamiltoni, kampioni në fuqi i Formulës 1, ka dominuar në garën e dytë të këtij sezoni, e cila është zhvilluar sërish në Austri. Britaniku ka marrë

"pole position" të shtunën, në provat të cilat janë realizuar në shi, ndërsa në garën e së dielës 35-vjeçari nuk pati kundërshtar, duke siguruar fitoren e 85-të në karrierën e tij brilante

në Formula 1. Ndërkohë, fituesi i garës së parë të këtij sezoni, piloti tjetër i Mercedesit, Bottas, arriti i dyti në finish, ndërsa podiumi u plotësua nga Max Verstappen. Një zhgënjim

total ishin dy pilotët e Ferrarit, Charles Leclerc dhe Sebastian Vettel në këtë garë, të cilët u përplasën të dy që në fillim, duke e mbyllur këtë garë ende pa nisur.



Rashica: Shumë shpejt do të dihet e ardhmja ime

PRISHTINË, 12 KORRIK - Milot Rashica është rikthyer në Kosovë dhe ishte i ftuar në emisionin "1 kafe me Labin". Ai ka folur për të ardhmen e vet dhe ka pranuar se menaxheri Altin Lala po bisedon me disa klube për të ardhmen e

tij. "Nuk kishim një sezon të mirë me Werder Bremenin. Në fund ia arritëm qëllimit të qëndronim në Bundesliga. Kam edhe dy vjet kontratë, por menaxheri im po bisedon me disa klube. Nëse gjejmë diçka të

mirë, edhe mund të lëviz", ka thënë Rashica. "Për momentin më duhet të them se jam ende pjesë e Werderit. Nuk kam diçka konkrete që të them. Jemi në pritje, në bisedime dhe besoj se shumë shpejt do të merret vesh

e ardhmja ime. Me Kosovën përpiqem ta jap gjithmonë maksimumin, pasi kemi më pak ndeshje dhe ne shqiptarët i përjetojmë shumë ndeshjet me kombëtaren", ka deklaruar Rashica.



Zemaj dhe Dumoshi kërkojnë nga federatat të respektohen masat e ndërmarra nga Qeveria dhe IKShPK-ja

PRISHTINË, 12 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe ministrja e Kulturës, Rinisë e Sportit, Vlora Dumoshi, të shtunën në mbrëmje kanë takuar kreun e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe drejtuesit e federatave të sporteve të Kosovës. Në këtë takim, Zemaj dhe Dumoshi shprehën falënderimin e tyre për punën e drejtuesve të federatave përmes së cilës kanë ndikuar që aktivitetet sportive të liruara gjatë kësaj periudhe të pandemisë Covid-19 të zhvillohen në kushte që ofrojnë sa më shumë siguri për shëndetin e sportistëve në Kosovë.

Ata i njoftuan krerët e federatave për nevojën që aktivitetet sportive të cilat janë në vijim t'i respektojnë me përgjegjësinë më të lartë masat e ndërmarra nga qeveria e vendit dhe rekomandimet e



IKShPK-së, me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit në mesin e komunitetit sportiv. Në këtë frymë, përfaqësuesit e federatave kanë informuar për garat e përfunduara për këtë sezon dhe ato në zhvillim, sfidat dhe angazhimin që brenda kushteve të lejuara, të ketë

siguri për sportistët dhe stafin përcjellës. Në njoftimin e MSh-së thuhet se Zemaj e Dumoshi kërkojnë që komunikimi midis institucioneve dhe federatave të jetë i përhershëm me qëllim që secili sektor ta kryejë pjesën e vet të përgjegjësisë për ta mundësuar ruajtjen e shëndetit publik të secilit komunitet.

Sarri: Atalanta, një prej ekipeve më të mira në Evropë

TORINO, 12 KORRIK - Trajneri i Juventusit, Maurizio Sarri, e ka quajtur të drejtë barazimin 2-2 ndaj Atalantës në "Allianz Stadium". Strategu i "Zonjës së Vjetër" nuk i ka kursyer elozhet për kundërshtarët, duke i cilësuar si një nga ekipet më të mira në Evropë. "Ne po luanim kundër një prej ekipeve më të mira në Evropë për momentin. Ata ishin të organizuar mirë, agresivë, kurse ne bëmë shumë gabime kur pasonim topin. Mënyra se si i kemi pësuar golat ishte vetëm nga humbja e topit. Të luash kundër Atalantës është shumë e vështirë. Në pjesën e parë vuajtëm disi por, fatmirësisht, rikuperuam në pjesën e dytë dhe dolëm me një pikë", ka thënë Sarri. "Ata vinin nga nëntë fitore radhazi dhe të luash kundër tyre është e vështirë për këdo, jo vetëm për ne. Ishte një ndeshje e vështirë edhe për sulmuesit tanë. Dybala duhej të kthehej mbrapa për ta rikuperuar topin.



Në fakt, zgjedha Higuainin, pasi ai krijon më shumë hapësira në zonën kundërshtare. Pjaniq në stol? Nuk ishte në formën e tij

më të mirë, prandaj nuk doja të rrezikojta ndonjë dëmtim muskolor, duke marrë parasysh", ka deklaruar Sarri.

SHKURT

Barça heq dorë nga transferimi i Neymarit

Ylli brazilian i PSG-së, Neymar JR, që një kohë të gjatë lidhet me një rikthim të mundshëm te Barcelona. "Marca" raporton se Barcelona është dorëzuar për transferimin e Neymarit për shkak të situatës ekonomike. PSG-ja në anën tjetër është e gatshme t'i plotësojë kushtet e Neymarit për ta mbajtur atë më gjatë në Paris.

White: Gjyqtarët i vodhën fitoren ish-kampionit

Presidenti i UFC, Dana White, doli hapur kundër vendimit të gjyqtarëve për duelin ndërmjet Alexander Volkanovskit dhe Max Holloway. Dana mendon se fituesi i vërtetë i duelit ishte Max, por vendimi i gabuar i gjyqtarëve bëri që titulli të mos kthehej në shtatullat e tij. "Nuk mund t'u lësh këtyre djemve. Kishim disa vendime të dobëta. Jam i sigurt se Holloway është shumë i zhgënjyer. A mendon dikush këtu se fitoi Volkanovski? Ndonjëri prej jush? Askush nga media? Nuk e di. Duhet të mendojmë që ta zgjidhim këtë problem. Duket se duhet të trajtojmë dhe të sjellim gjyqtarë më të mirë këtu në 'Fight Island'", ka thënë Dana që doli në krah të ish-kampionit Holloway.

Unitedi arrin marrëveshje me Chiesan

Ylli i Fiorentinës, Federico Chiesa, ka arritur marrëveshje me skuadrën e Manchester Unitedit, kanë njoftuar mediat në Angli. Talenti italian ishte synim i Juventusit dhe Interit, por oferta e Unitedit prej 53 milionë eurosh ka qenë me bindëse për Chiesan. 22-vjeçari në Serinë A me Fiorentinën është paraqitur në 127 ndeshje dhe ka realizuar 21 gola.

Përfundon sezoni në La Liga për Griezmannin

Ka përfunduar sezoni 2019/20 në La Liga për sulmuesin e Barcelonës, Antoine Griezmann, i cili e ka pësuar një lëndim muskolor që do t'i marrë kohë për t'u riaftësuar. Sulmuesi francez u detyrua ta braktisë fushën në përfundim të pjesës së parë në fitoren e Barcelonës 1-0 kundër Real Valladolidit të shtunën. Klubi katalonas e ka konfirmuar lëndimin e tij, por nuk ka treguar saktësisht se sa kohë do t'i duhet për t'u rikuperuar. Synimi i Griezmannit është të riaftësohet deri më 8 gusht, për ndeshjen e kthimit në 1/8 e finales në Ligën e Kampionëve që Barça e zhvillon kundër Napolit në "Camp Nou".

Latifi, afër rikthimit në Shqipëri

Liridon Latifi është një emër që mund të kthehet në Shqipëri dhe ta pasurojë elitën e futbollit shqiptar. Lojtari që dha aq shumë te Skënderbeu me nivelin e treguar në fushën e lojës, duke luajtur edhe në grupet e Ligës së Evropës, bëri kalimin e parë jashtë Shqipërisë te Puskas Akademi. Skuadra hungareze nuk rezultoi "toka e premtuar" për Latifin. Pas kësaj aventure do të niste një e re në Moldavi teksa kaloi te Sherif Tiraspol. Por edhe në këtë skuadër sulmuesi shqiptar nuk po arrin që të lërë gjurmë. Madje në dy takimet e fundit nuk është grumbulluar me skuadrën. Mësohet se Liridon Latifi ka marrë një ofertë nga një klub i madh në Shqipëri, ndërsa klubi që i zotëron kartonin e pëlqen idenë për një kalim të tillë, duke ditur shpërthimin që merr sulmuesi në Superiore. Problemi i vetëm mbetet pagesa pasi Latifi fiton rreth 25 mijë euro dhe oferta nga Shqipëria nuk i përgjigjet deri në këtë pikë, duke kërkuar nga ekipi që e zotëron ta mbyllë gjysmën e rrogës. Marrëveshja ka ngecur në këtë pikë pasi nuk dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë pas krizës së kaluar në aspektin financiar, për ta paguar lojtarin do t'i shërbejë për disa kohë një ekipi tjetër.



Autor: GAZMEND MORINA					KËNGËTARJA SHQIPTARE NË FOTO	MARKË E VESHJEVE SPORTIVE	ZUTPHENSE INDUSTRIE LAS	DIJETAR FETAR MYSLIMAN	BASHKËT.	EPOKA ERE	FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN	KULAÇE	ARKAT	AMPER, RENIUM	DESPOTI
LËNG I TRASHË QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTAËS										ZOG ROSE, BIBË (sh.shq.) BASHKËT.					
JETË E QETË DHE E LUMTUR (libr.)									BIXHOZI TRAJNERI SPANJOLL VILANOVA						
POPULL (krah.)										AKTORI RAFUNA DYSHEK I MBUSHUR ME KASHTË (vjet.)					
OLIVIER DACURT							TËRËSIA E LËVIZJEVE TË PJESEVE TË FYTYRËS INICIATIVAT							ZANORE NJËSI KOHE	
MJESHTËRIA QË USHTRON DIKUSH PËRDITË										"IRLANDA"	TONELATË AKTORI ÇELAJ				
KAMPIONI (Sport)								ISH BASKET-BOLLISTI SHEKIL SHPEND MË QAFË TË GJATË (sh.shq.)				RENS ISTVUD	ISH FUTBOLLISTI KROAT IGOR		
SHJAKU						DY BASHKËTINGËLLORE GJENDJA E PA PUSHTET			KLUB I YNI FUTBOLLI RAVENA						AKADEMIKU STAVILECI
EPOKA ERE	QYTET NË MAQEDONI	USHQEVA FOSHNJËN	KËNGËTARE E JONA	DJALL (hebr.)	EPOKA ERE	VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE BASHKËT.					"RUANDA" "A" në mes të dy "I"			ZANORE I PAMOR-ALSHËM	
SHKURTOJ, HEQ, KRASIT					AKTORI QOSJA "RISANI"				BANOR I KRYEQYTETIT TË ARABISË SAUDITE TATUAZH (bised.)						
RADIOLOKATOR					DITË E SHËNUAR NË KALENDAR (sh.shq.)					ENDE PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE					
MËRIA, ZILIA AKTORJA DUSHKU					ROBERT REDFORD VEGËL MUZIKORE		TASH AUSTRALIAN ACCESS HIRE				RESIDENTIAL TENANCY OFFICE MARRJE E TIPAREVE TË ILIRËVE				
→					FUTBOLLIST BRAZILIAN (R. MADRID) KLUB FUTBOLLI NË SPANJË			TEDI ALVES MOTRA E BURRIT			ZANORE AKTORJA E FAMSHME THURMAN		BASHKËT. URUGUAI		ÇËSHTJE QË SHQYRTOHET NGA ANA LIGJORE (drejt.)
HIDROKARBUR I PANGOPUR					I GRUMBULLUAR DJALI KUNDREJT PRINDËRVE TË VET										
PHOENIX ASSOCIATION REALTORS				MËNGJESI (turq.) DEM					LLOJ VETURE FRANCEZE ANGOLA, ZAMBIA			NOTË MUZIKORE KRYEHOXHË			
ZANORE		FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË GRYKA E VULLKANIT				BASHKËVENDËSE E ODISEUT	MENDJEHOLLI							BASHKËT. SHTAZORE	
EPOKA ERE	BASHKËT. ISH BOKSIERI YNË LIKA		SHTET I LASHTË NË AZI (pashq.) TENISTJA KURNIKOVA				NJË KON-TINENT KALIBËR I TYTËS SË ARMËS				I PESHOJ PËMË E VENDEVE TROPICALE				
TOKA E BUKËS				BASHKIM I FORTË ANDORA					ISHULLI MË I MADH NË SHQIPËRISË DY BASHKËTINGËLLORE						
PËMË E VENDEVE TROPICALE					SULM PREZANTUESIA SHQIPTARE GJONI					RILINDËSI PETRO LUARASI LLOJ REVOLEJE					I PESHOJ (krah.)
SHKRONJË GREKE			GADISHULL NË GREQI KËNGËTARJA ... KOÇI					MODELJA KANADEZE JESSICA EDITA SOPJANI					BREJTËS I VOGËL SHTEG		
"DETROIT"			ZANORE ERNEST KOLIQI		JETËSHKRIM ARMENIA				DY BASHKËTINGËLLORE ANTON PASHKU			KORNIZË NAIM ISMAJLI			
AKTORJA CAHANI					I PËRFUNDOVA, I BITISA ZANORE										
MODELJA ME FAMË BOTËRORE TAYLOR				QYTET I MADH NË GJERMANI				RRUGA QË BËN TOPI KUR I KALOHEM NJË LOJTARI TJETËR (sh.shq.)							

SHPALLJE PËR SHITJE

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh" Magure

Ndërmarrja e Re (N.R.) "MIM Golesh", Magure e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së, SHPALLË këtë:

FTESË PËR OFERTË
PËR SHITJEN E MATERIALVE

EMRI ZYRTAR: Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"

ADRESA POSTARE: Magure

I. LËNDA E KONTRATËS;

Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e materialeve si vijon:

1. Dunit I thërrmuar, fraksion 0 – 4mm , rreth 13800 m³,
2. Dunit I thërrmuar, fraksion 4 – 8 mm , rreth 2500 m³,
3. Dunit I thërrmuar, fraksion 8 – 11 mm rreth 1100 m³ dhe
4. Shkëmbinj ultrabazik (material për mbushje), fraksion – 60 mm , rreth 36700 m³

II. KUSHTET E OFERTIMIT:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, numrit fiskal, certifikata e TVSH-se, numrin e telefonit kontaktues dhe adresa. Oferta duhet të përmbaj çmimin me TVSH, duhet të jete shume e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

III. VIZITA E MATERIALEVE

Palët e interesuara, materialet e larte cekura mundë ti shikojnë prej datës 07.07.2020 deri me 12.07.2020 prej orës 10:00h deri në orën 14:00h përmes personit kontaktues z. Shefik Imeri, nr. tel mob. 049/455-869 ose fix. 038/588-700.

IV. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES:

1. Çmimi më i lartë i ofruar për m³ të materialit

V. AFATI KOHOR DHE VENDI PER DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen me datën **13.07.2020** nga ora **13⁰⁰** deri në orën **14⁰⁰** në adresën e mëposhtme: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.Ofertat do të hapen me datë **13.07.2020** në ora **14¹⁰** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

VI. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Hag Tobacco" Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e produkteve te duhanit dhe ambalazhimin e nargiles në Matiqan, Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.08.2020 në ora 09:30 në lokalet e kompanisë "Hag Tobacco" lagja e Spitalit rruga "Nazim Muja, Matiqan, Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania "Hag Tobacco" Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e produkteve te duhanit dhe ambalazhimin e nargiles në Matiqan, Prishtinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNUNGQrZVFOM3RnU0d2K283Zz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë


www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sadik Brava shpall të pavlefshme dëftesat e viteve I, II, III dhe IV si dhe diplomën e Gjimnazit "Skënderbeu" Kaçanik.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULË

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues